



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

RAPORTI I
FUNKSIONIMIT TË
KOMUNAVE TË
REPUBLIKËS SË
KOSOVËS

Janar - Dhjetor 2016

Përmbajtja

Hyrje	3
Qëllimi i raportit	4
Përmbledhje ekzekutive	5
1. Kuvendet e Komunave	8
1.1. Funksionimi i Kuvendeve të Komunave	8
1.2. Komitetet e Përhershme, Komitetet Tjera dhe Komitetet Konsultative	9
1.3. Komitetet konsultative	11
1.4. Raportimi i Kryetarit të Komunës	11
1.5. Takimet Publike me Qytetarë	12
1.6. Aktet komunale	14
1.7. Shqyrtimi i ligjshmërisë së akteve komunale	14
1.7.1. Veprimet për harmonizimin e akteve të kundërligjshme nga komunat	15
1.8. Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi	17
2. Agjenda Evropiane	20
2.1. Vlerësim i përgjithshëm i përmbushjes së obligimeve të komunave	20
2.1.2. Avokati i Popullit	22
2.1.3. Shoqëria Civile	23
2.1.4. Lufta Kundër Korrupsionit	23
2.1.5. Riintegrimi dhe Ripranimi	24
2.1.6. Të Drejtat e Njeriut dhe Mbrojtja e Minoriteteve	24
2.1.7. Mbrojtja dhe Promovimi i Trashëgimisë Kulturore	25
2.2. Kriteret Ekonomike	26
2.2.1. Ekonomia e tregut	26
2.3. Standardet Evropiane	27
2.3.1. "One-Stop Shop"	27
2.3.2. Shoqëria e Informacionit dhe Mediat	27
2.3.3. Transporti	27
2.3.4. Energjia	28
2.3.5. Gjyqësori dhe të drejtat themelore	28
2.3.5. Drejtësia, Liria dhe Siguria	30
2.3.6. Arsimi dhe Kultura	30
2.3.7. Mjedisi	31
2.3.8. Bujqësia	32
2.3.9. Bashkëpunimi ndërkomunal dhe komunal ndërkombëtar	32
3. Financat Lokale	33
3.1. Planifikimi i të hyrave vetanake	33
3.2. Realizimi i të hyrave vetanake	33
3.3. Buxhetimi komunal për vitin 2016	34
3.4. Shpenzimet krahasuar me buxhetimin	34
Përfundime	36
Rekomandimet e përgjithshme	37

Hyrje

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal harton rregullisht raportin për funksionimin e komunave, duke vlerësuar progresin e komunave drejt përmbushjes së obligimeve ligjore, zbatimin e kompetencave, si dhe nivelin e përmbushjes së përgjegjësiqve që lidhen me realizimin e kërkesave dhe interesave të qytetarëve.

Ky raport ndjek këtë strukturë::

- Raporti përshkruan funksionimin e kuvendeve të komunave dhe ekzekutivit të komunës;
- Shkurtimisht paraqet rezultatet e punës së organeve komunale, me theks të veçantë kuvendit të komunës si organi më i lartë në komunë;
- Analizon pjesë të transparencës komunale;
- Shqyrton hapat e komunave në zbatimin e obligimeve nga Programi Kombëtar për MSA;
- Paraqet të dhënat për planifikimin e buxheteve komunale, realizimin e të hyrave dhe shpenzimet buxhetore;

Raporti përfshinë periudhën Janar - Dhjetor 2016.

Raporti bazohet në të dhënat e mbledhura dhe të analizuara nga Departamentet përkatëse të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal. Gjithashtu, janë përdorur edhe burime të tjera, duke përfshirë përgjigjet e zyrtarëve komunal në pyetjet e parashtruara, Sistemi Informativ i Menaxhimit të Financave të Kosovës – SIMFK, Departamenti i Thesarit - MF, si dhe të dhënat e siguruara nga monitorimi i drejtpërdrejtë i komunave.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal nxjerr konkluzione të detajuara lidhur me funksionimin e organeve komunale dhe hapave të cilët komunat duhet ndërmarrin në të ardhmen.

Qëllimi i raportit

Ky raport ka për qëllim informimin e drejtë të institucioneve qendrore, komunave, qytetarëve, organizatave joqeveritare, dhe çdo grupi tjetër të interesit, për nivelin e funksionimit të komunave sipas mandatit ligjor që kanë.

Përmes këtij raporti jemi munduar të krijojmë një pasqyrim të qartë lidhur me aktivitetet e organeve të komunave. Gjithashtu, raporti shërben si mjet për të rritur transparencën dhe efikasitetin e organeve të komunave.

Në këtë raport janë përfshirë të dhënat e përgjithshme të punëve dhe aktiviteteve të organeve të komunave, për vitin 2016. Po ashtu, janë përfshirë gjetjet më të rëndësishme të evidentuara gjatë këtij viti.

Në kuadër të raportit, janë përfshirë të dhënat për 38 komuna të Republikës së Kosovës. Vlerësojmë se informacionet e ofruara në këtë raport, e në veçanti gjetjet e paraqitura, do të shërbejnë në të mirë të proceseve të vetëqeverisjes lokale, të rrisin përgjegjësinë institucionale dhe komunat të ndërmarrin hapa konkret në përmirësimin e veprimeve kundërligjore.

Përmbledhje ekzekutive

Gjatë vitit 2016 komunat kanë ushtruar funksioneve të tyre në përputhje me kompetencat e përcaktuara në legjislacionin e zbatueshëm dhe në përputhje me prioritetet e vendit të cilat dalin nga dokumentet kryesore strategjike, duke përfshirë Strategjinë për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026, strategjitë sektoriale, si dhe një pjesë të konsiderueshme të obligimeve të parapara në Programin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Aasociimit.

Bazuar në planifikimin vjetor për vitin 2016, kuvendet e komunave kanë zhvilluar rregullisht aktivitetet e tyre, kështu duke aprovuar edhe një numër të konsiderueshëm të akteve nënligjore. Sa u përket mbarëvajtjes së mbledhjeve, ato kanë qenë të hapura për qytetarët duke përfshirë edhe njoftimet me kohë për mbajtjen e punimeve. Vetëm në një rast në Komunën e Deçanit, kuvendi i komunës ka vendosur që mbledhja të jetë e mbyllur.

Në përgjithësi, komunat kanë respektuar ligjet e aplikueshme me rastin e zhvillimit të aktivitetit normativ të tyre. Nga aspekti sasior, kuvendet kanë mbajtur 495 mbledhje, prej të cilave 420 mbledhje kanë qenë të rregullta, 49 të jashtëzakonshme, 21 solemne dhe 5 urgjente. Krahas kuvendeve, komitetet e obligueshme kanë funksionuar rregullisht duke shqyrtuar dokumentet financiare, planet, propozim-vendimet, projekt-rregulloret dhe çështjet e tjera politiko-financiare. Gjatë kësaj periudhe, Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur 417 mbledhje, kurse Komiteti për Komunitete ka mbajtur 359 sosh. Në kuvendet e komunave janë themeluar një numër i madh i komiteteve të tjera ndihmëse, nga të cilat dominojnë komitetet për shërbime publike, shëndetësi, arsim dhe planifikim hapësinor. Krahas tyre, janë funksionale edhe 33 komitete konsultative në 18 komuna.

Gjatë kësaj periudhe, komunat kanë shfrytëzuar edhe mekanizmat e tjerë të përfshirjes së qytetarëve në politikbërje, veçanërisht gjatë organizimit të takimeve publike gjithëpërfshirëse me qytetarë dhe konsultimeve publike gjatë procesit të hartimit të projekt-akteve komunale. Në total janë mbajtur 64 takime publike me qytetarë në 32 komuna, 311 konsultime me rastin e hartimit të projekt-akteve po ashtu në 32 komuna, si dhe 200 dëgjime publike buxhetore në 31 komuna. E drejta e përfshirjes së qytetarëve në konsultime publike duhet të shtrihet në të gjitha komunat.

Për të siguruar efikasitetin e ekzekutivit të komunës në zbatimin e politikave, kuvendet e komunave kanë kërkuar raportim të rregullt nga kryetarët e komunave dhe raportime të tjera shtesë. Sipas të dhënave, kryetarët e komunave kanë përmbushur normën ligjore të raportimit të rregullt para kuvendeve të komunave, veçanërisht për gjendjen ekonomiko-financiare gjatë vitit 2016. Në këtë drejtim ka pasur 101 raportime të kryetarëve në 37 komuna, me përjashtim të Kryetarit të Komunës së Kllokotit, i cili nuk ka raportuar asnjëherë gjatë kësaj periudhe.

Kuvendet e Komunave kanë qenë mjaft aktive në miratimin e akteve komunale. Shikuar nga aspekti kuantitativ, gjatë vitit 2016 kuvendet e komunave kanë miratuar gjithsej 148 rregullore dhe 1678 vendime. Nga gjithsej 1826 akte të miratuara nga kuvendet e komunave, MAPL ka bërë vlerësimin e ligjshmërisë së 810 akteve, ndërsa në ministri të linjës janë dërguar 1016 akte për vlerësim të ligjshmërisë. Gjatë procesit të vlerësimit të ligjshmërisë MAPL ka konstatuar ligjshmërinë e 772 akteve, kurse 38 akte janë vlerësuar si të kundërligjshme. Për këtë ministria ka parashtruar kërkesat për rishqyrtim të këtyre akteve në komunat përkatëse, prej të cilave janë harmonizuar 18 akte konform kërkesës për rishqyrtim. Ndërsa 20 shkelje ende nuk janë harmonizuar në përputhje me kërkesën e organit mbikëqyrës nga komunat si vijon: Kamenica (1),

Ranillugu (1), Graçanica (4), Gjakova (2), Zubin Potok (1), Gllogovc (1), Dragash (1), Deçan (1), Novobërdë (1), Obiliq (1), Malishevë (2), Klllokot (3)

Rishikimi dhe harmonizimi i akteve të komunave të cilat janë cilësuar të kundërligjshme duhet të vazhdojë deri në evitimin e të gjitha çështjeve të kontestuara nga autoriteti mbikëqyrës. Gjithashtu, shqyrtimi i ligjshmërisë nga ministrët e linjës duhet të ndodhë brenda afateve ligjore, si dhe të shtohen përpjekjet për rishqyrtim dhe harmonizim të akteve të kundërligjshme nga komunat.

Në komuna ka vazhduar trajtimi i çështjeve të sigurisë nga ana e Këshillave Komunale për Siguri në Bashkësi. Ky Këshill aktualisht është i themeluar në 34 komuna, ndërsa nuk është themeluar në Komunat: Leposaviq, Mitrovicë Veriore, Zveçan dhe Zubin Potok. Megjithatë, KKSB-të e komunave: Fushë Kosovë dhe Klllokot nuk kanë mbajtur asnjë takim në periudhën raportuese, si dhe komuna e Prishtinës ka mbajtur vetëm një takim duke mos respektuar minimumin e paraparë për 6 takime sipas Udhëzimit Administrativ për KKSB. Krahës tyre, shumica e KKSB-ve të komunave të tjera janë brenda normës së paraparë ligjore për mbajtje të takimeve. Çështjet më të trajtuara gjatë periudhës raportuese rreth problemeve të sigurisë në bashkësi kanë qenë: siguria në shkollë, siguria në trafik, trajtimi i qenve endacak, parandalimi i krimit dhe sjelljeve të dhunshme, parandalimi i përdorimit të armëve në ahengje, mbrojtja e pyjeve, zvogëlimi i përdorimit të substancave narkotike kryesisht nga të rinjtë, etj. Si rezultat i trajtimit të këtyre çështjeve nga KKSB, komunat kanë realizuar një numër të madh të projekteve të sigurisë që adresojnë problemet në fjalë.

Kosova tani ka hyrë në një kapitull të rëndësishëm të proceseve integruese me Bashkimin Evropian. Në pajtim me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit (MSA) të nënshkruar nga Republika e Kosovës dhe Bashkimi Evropian, e hyrë në fuqi më 1 prill 2016, si dhe Programin Kombëtar për zbatim të MSA-së të aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 10 mars 2016, MAPL ka ndërmarrë veprime për adresimin dhe zbatimin e obligimeve të komunave në kuadër të tri kriterëve kryesorë (politike, ekonomike dhe standardet evropiane). Në mënyrë të veçantë janë përgatitur matricat individuale të komunave nga obligimet e agjendës evropiane, duke përfshirë: Dialogun për Procesin e Stabilizim Asociimit dhe PKZMSA-në, si dhe sfidat nga Raporti i KE-së për Kosovën (pjesa e sfidave të komunave), mbi bazën e së cilave janë ofruar të dhënat në këtë raport.

Lidhur me obligimet e dala nga agjenda evropiane, komunat kanë arritur të përmbushin 78% të aktiviteteve të parapara në fushën e kriterëve politike. Sa i përket kriterëve ekonomike, komunat kanë përmbushur 75% të aktiviteteve të parapara, ndërsa në fushën e standardeve evropiane, komunat kanë realizuar 68% të aktiviteteve. Nga kjo mund të shohim se niveli i përmbushjes së obligimeve të komunave nga agjenda evropiane për vitin 2016 ka qenë 73%.

Në vazhden e aktiviteteve të tyre, në 36 komuna janë mbajtur 825 trajnime për zyrtarët komunal, ku janë trajnuar 1506 zyrtarë. Mesatarisht janë organizuar 23 trajnime për çdo komunë me nga 42 zyrtarë të trajnuar. Në kuadër të kësaj, 28 komuna kanë organizuar 101 trajnime në fushën e të drejtave të njeriut, kurse 10 komuna nuk kanë organizuar ndonjë trajnim në këtë fushë.

Lidhur me respektimin e gjuhëve zyrtare në komuna, 34 komuna kanë nxjerrë rregulloren për përdorimin e gjuhëve zyrtare, kurse 4 komunat: Mitrovicë Veriore, Ranillugu, Zveçani dhe Leposaviqi ende nuk i kanë hartuar këto rregullore. Krahës kësaj, 31 komuna kanë publikuar rregullisht në ueb-faqet zyrtare aktet e nxjerra nga organet e komunës në gjuhët zyrtare. Ndërsa, 3 komuna (*Mamushë, Malishevë dhe Podujevë*) publikimin e akteve e kanë bërë pjesërisht, si

dhe 4 komuna të tjera (*Leposaviq, Mitrovicë Veriore, Partesh dhe Zubin Potok*) ueb faqet e komunave nuk i kanë funksionale.

Në 36 komuna janë themeluar Qendrat për Shërbim të Qytetarëve, ndërsa nuk janë themeluar në Komunën e Zveçanit dhe Leposaviqit. Gjithashtu, procesi i funksionalizimit të administratës komunale ka filluar në 4 komuna: Mitrovicë Veriore, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan.

Sa i përket të punësuarve nga radhët e pjesëtarëve të komuniteteve minoritare në administratën komunale, numri i tyre në 32 komuna është 1402, ndërsa në 6 komuna: Obiliq, Kaçanik, Zubin Potok Junik, Glogoc, dhe Hani Elezit, nuk ka ndonjë të punësuar nga radhët e komuniteteve joshumicë në administratën e komunës. Veç tyre, numri i përfaqësimit të femrave në pozita menaxheriale në 35 komuna është 427, kurse numri i përfaqësimit të femrave në përgjithësi në administratën komunale dhe kuvendet e komunave është 2483.

Me qëllim të përkrahjes së aktiviteteve të OJQ-ve, 26 komuna kanë financuar 705 projekte të OJQ-ve në vlerë totale prej 2,668,942.99€. Krahas tyre, 12 komuna: Shtërpçë, Leposaviq, Dragash, Mamushë, Mitrovicë Veriore, Partesh, Zubin Potok, Gjilan, Novobërdë, Ranillug, Klllokot dhe Hani Elezit, nuk kanë pasur projekte të financuara.

Në 22 komuna janë mbajtur 189 aktivitete për të drejtat e njeriut për trajtimin e temave të ndryshme, si: barazia gjinore, të drejtat trashëgimore, të drejtat e fëmijëve, kundërdiskriminimi, etj. Me qëllim të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, 19 komuna kanë aprovuar Rregulloren për të drejtat e fëmijëve.

Komunat kanë ndërmarrë edhe veprime përpërkrahjen e bizneseve. Në 33 komuna numri i bizneseve të reja të regjistruara është gjithsej 6731, kurse numri i bizneseve të mbyllura është 1984. Sa i përket ndarjes së buxhetit të veçantë për subvencionimin e bizneseve, 14 komuna kanë raportuar se kanë ndarë buxhet për këtë qëllim.

Në 37 komuna është arritur të ketë shtrirje të internetit në të gjitha institucionet publike, përfshirë: Shkollat, Ambulancat, Zyret e Vendit, ndërsa në Komunën e Leposaviqit ende ka nevojë për zgjerim të rrjetit të internetit në të gjitha institucionet. Sa i përket infrastrukturës rrugore, sipas të dhënave të raportuara nga 35 komuna, është arritur që të asfaltohen 73% të rrugëve lokale në gjithë vendin. Gjithashtu, 29 komuna kanë hartuar Planin për Energji Efiçente, ndërsa mbetet të hartohet në 9 komuna, si: Mamushë, Mitrovicë Veriore, Skenderaj, Leposaviq, Ranillug, Klllokot, Hani Elezit, Graçanicë dhe Prishtinë.

Lidhur me performancën e komunave në menaxhimin e buxhetit, gjatë vitit 2016 përgjithësisht vërehet progres në këtë fushë. Kësisoj, planifikimi i të hyrave vetanake për vitin 2016 në vlerë prej 79,622,353.00€ ka qenë më i madh për 7% në krahasim me vitin 2015. Përveç kësaj, realizimi i të hyrave direkte dhe indirekte në vitin 2016 ka qenë 71,025,872.71€, ose 89%. Ndërsa, sa i përket shpenzimeve, në vitin 2016 komunat kanë shpenzuar buxhetet e tyre në vlerë të përgjithshme prej 404,141,917.32 € ose 91% të buxhetit të planifikuar. Gjithsej janë 31 komuna të cilat kanë arritur të shpenzojnë buxhetin në nivel më të lartë prej 91% - 99%, 4 komuna në nivelin prej 80%-88% dhe 3 komuna në 56%-63% të buxhetit.

1. Kuvendet e Komunave

1.1. Funksionimi i Kuvendeve të Komunave

Kuvendi i Komunës është organi më i lartë vendimmarrës i komunës, i cili funksionon në bazë të kornizës ligjore për vetëqeverisjen lokale në Republikën e Kosovës. Kompetencat dhe përgjegjësitë e kuvendit të komunës derivojnë nga Ligji për vetëqeverisje lokale dhe ligjet e tjera të cilat rregullojnë çështje të caktuara nga fusha e vetëqeverisjes lokale. Ndër përgjegjësitë kryesore të kuvendit të komunës është edhe miratimi i akteve juridike nënligjore të cilat sigurojnë mbarëvajtjen dhe funksionimin efikas të komunës. Përmes këtyre akteve rrjedhin autorizimet përkatëse të ekzekutivit komunal për nxjerrjen e akteve administrative dhe ekzekutimin e tyre.

Për të ushtruar kompetencat, kuvendi i komunës mbledhet në baza të rregullta periodike, apo në raste të mbledhjeve të jashtëzakonshme dhe urgjente. Gjatë vitit 2016, në Republikën e Kosovës kanë funksionuar kuvendet e 38 komunave. Mbledhjet janë mbajtur rregullisht dhe kanë qenë të hapura për publikun. Sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Kuvendi i Komunës duhet të mbaj së paku 10 mbledhjeve në vit, pesë prej të cilave duhet të mbahen në gjashtëmujorin e parë të vitit.




Fig.1. Numri i përgjithshëm i mbledhjeve të Kuvendeve të Komunave, Janar-Dhjetor 2016

Nga figura më lartë, vërejmë se gjatë vitit 2016, kuvendet e komunave të Republikës së Kosovës kanë mbajtur gjithsej 495 mbledhje. Prej tyre 420 mbledhje kanë qenë të rregullta, 49 të jashtëzakonshme, 21 mbledhje solemne dhe 5 mbledhje urgjente.

Më poshtë, janë paraqitur statistikat e mbledhjeve për komunat veç e veç, si vijon:



Fig.2. Numri i mbledhjeve të KK-ve sipas komunave

Ngase vërejmë më lartë, të gjitha komunat kanë qenë aktive në mbajtjen e mbledhjeve të kuvendeve të tyre, duke përmbushur normën për minimumin e përgjithshëm të takimeve të parapara me ligj.

Gjatë zhvillimit të punës së kuvendeve, janë shënuar disa raste të bojkotimit të mbledhjeve nga anëtarët e kuvendeve të komunave: Ferizaj, Fushë-Kosovë, Mitrovicë Jugore, Shtime dhe Istog. Po ashtu, vetëm në një rast në Kuvendin e Komunës së Deçanit mbledhja nuk ka qenë e hapur për publikun.¹ Gjithsesi duhet saktësuar se sa i përket mbarëvajtjes së mbledhjeve të kuvendeve dhe funksionimit të tyre, komunat kanë respektuar ligjet e aplikueshme të Republikës së Kosovës.

Informimi i qytetarëve në vazhdimësi është bërë përmes faqes zyrtare të komunës shpalljeve të vendosura në objektet e komunave, televizioneve lokale dhe forma të tjera të informimit publik. Nga kjo rrjedh që komunat janë kujdesur që ngjarjet e tyre t'i zhvillojnë në mënyrë transparente, duke publikuar në faqet zyrtare elektronike aktivitetet e kryera nga kuvendet e komunave si dhe ekzekutivi i komunës.

1.2. Komitetet e Përhershme, Komitetet Tjera dhe Komitetet Konsultative

Bazuar në legjislacionin për vetëqeverisje lokale, kuvendet e komunave themelojnë komitetet e përhershme (obligueshme) për të mbështetur punën e tyre, përkatësisht Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Komitetin për Komunitete. Me qëllim të mbështetjes së organeve të komunës (kuvendit dhe ekzekutivit) në ushtrimin e kompetencave sektoriale, Kuvendi i Komunës mund të themeloj edhe komitete të tjera profesionale. Këto komitete kryesisht janë themeluar për sektorët specifik si në: arsim, shëndetësi, zhvillim ekonomik, shërbime publike etj. Veç tyre, Kuvendi i Komunës ka përgjegjësi të themeloj edhe komitetet konsultative brenda sektorëve me qëllim që të bëj të mundur pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes.

Sa u përket funksionimit të tyre, Komiteti për Politikë dhe Financa dhe Komiteti për Komunitete kanë qenë funksionale në të gjitha komunat. Më poshtë është paraqitur figura me krahasuese e numrit të mbledhjeve të komiteve obligative:

¹ Me rastin e trajtimit të pikës së rendit të ditës për Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës Nr. KI 132/15 dhe Nr. Ref: AGJ 943/16 të datës 20 maj 2016, lidhur me pronat e komunës që u janë dhënë Manastirit të Deçanit.




Fig.3. Numri i mbledhjeve të komiteteve të përhershme sipas komunave

Siç shohim nga figura Nr.3, për nga numri, 417 mbledhje kanë mbajtur Komitetet për Politikë dhe Financa (KPF), kurse 359 mbledhje Komitetet për Komunitete (KK).




Fig.4. Llojet e komiteteve të tjera të themeluara në komuna

Sipas figurës 4 në kuvendet e komunave janë themeluar një numër i madh i komiteteve të tjera, në të cilat dominon komiteti për shërbime publike, shëndetësi, arsim dhe planifikim hapësinor, të elaboruar më saktësisht si më poshtë:

- **Komiteti për shëndetësi** - 15 komuna: Deçani, Partesh, Klllokot, Malishevë, Prizren, Fushë Kosovë, Gjilan, Mitrovicë jugore, Ferizaj, Prishtinë, Podujevë, Lipjan, Klinë, Viti dhe Pejë).
- **Komiteti për arsim, kulturë, rini dhe sport** - 14 komuna: Deçani, Partesh, Klllokot, Malishevë, Gjakova, Prizreni, Fushë Kosova, Mamusha, Gjilani, Mitrovica Jugore, Ferizaj, Prishtinë, Podujevë dhe Viti.

- **Komiteti për Planifikim Hapësinor** - 8 komuna: Deçani, Prizreni, Gjlani, Prishtina, Podujeva, Lipjani, Klinë dhe Viti
- **Komiteti për Bujqësi** - 2 komuna: Klllokot dhe Fushë-Kosovë.
- **Komiteti për zhvillim ekonomik**- 6 komuna: Fushë Kosova, Gjlani, Mitrovica Jugore, Ferizaj, Prishtina dhe Podujeva.
- **Komiteti për Urbanizëm** - 5 komuna: Deçani, Prizreni, Fushë Kosova, Mitrovica Jugore dhe Ferizaj.
- **Komiteti për Banim Social** - 2 komuna: Deçani dhe Prizreni.
- **Komiteti për Shërbime Publike** - 17 komuna: Deçani, Partesh, Ranillugu, Gjakova, Prizreni, Mamusha, Rahovec, Fushë Kosova, Gjlani, Kaçaniku, Mitrovica Jugore, Shtime, Juniku, Prishtina, Lipjan, Klinë dhe Pejë.
- **Komitetin për Pronë** – Komuna e Gjilanit.
- **Komiteti për persona me aftësi të kufizuara**: 2 komuna: Fushë Kosova dhe Ferizaj.
- **Komiteti për kategoritë e dala nga lufta**: komuna e Ferizajit.
- **Komiteti për shndërrimin e tokës bujqësore në jo bujqësore**: Komuna e Gjakovës.
- **Komiteti për Bashkëpunim Ndërkufitar** - 2 komuna: Gjlani dhe Viti.
- **Komiteti për Barazi Gjinore** - 3 komuna: Prizreni, Gjlani dhe Mitrovicë Jugore.

1.3. Komitetet konsultative

Instrumente mjaft të zhvilluara të përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrjen lokale janë edhe Komitetet Konsultative. Krahas formave të tjera, siç janë referendumi lokal, peticioni dhe iniciativat qytetare që janë më pak të shprehura, komunat në një masë kanë praktikuar themelimin e komiteteve konsultative. Formimi dhe mënyra e funksionimit të këtyre komiteteve është rregulluar me ligj dhe akte nënligjore. Duke parë qëllimin e ligjvënësit për themelimin e këtyre mekanizmave, komunat edhe më tepër duhet t'iu japin hapësirë veprimi. Aktualisht, janë funksionale 33 komitete konsultative në 18 komuna, përfshirë 8 komuna të cilat gjatë vitit 2016 kanë themeluar komitete të tilla. Si rregull anëtarët e këtyre komiteteve marrin kompensim për angazhimin e tyre në këto komitete. Komunat të cilat kanë themeluar komitete konsultative janë: Gjilan, Mitrovicë Jugore, Ferizaj, Fushë Kosovë, Prishtinë, Skenderaj, Prishtinë, Podujevë, Pejë, Klinë, Lipjan, Malishevë, Prizren, Deçan, Junik, Shtime, Istog, Drenas, Kamenicë, Vushtrri, Hani i Elezit. Numri më i madh i këtyre komiteteve është themeluar në fushën e arsimit, kulturës, rinisë dhe sportit, zhvillimit ekonomik lokal, shërbimeve publike, si dhe shëndetësisë dhe mirëqenies sociale.

1.4. Raportimi i Kryetarit të Komunës

Mbikëqyrja dhe raportimi përbëjnë një proces mjaft të rëndësishëm të qeverisjes lokale, përmes të cilit mundësohet përcjellja sistematike të ngjarjeve dhe aktiviteteve brenda komunës. Kuvendi i komunës është organ i autorizuar me ligj për kontrollin e kryetarit të komunës. Nga ky aspekt, raportimi është një mjet kontrolli, të cilin e zbaton kuvendi i komunës ndaj kryetarit për të siguruar zbatimin e politikave të planifikuara. Raportimi shikohet edhe si formë e bashkëpunimit që mundëson funksionimin komplementar të dy organeve, kuvendit dhe kryetarit. Ligji për vetëqeverisje lokale ka përcaktuar përgjegjësinë e Kryetarit të Komunës për të raportuar në intervale të rregullta ose atëherë kur kërkohet nga Kuvendi i Komunës. Të drejtën për të kërkuar raportim nga ekzekutivi e kanë ad hoc edhe anëtarët e kuvendeve të komunave, çdo herë kur e vlerësojnë të nevojshme. Për këtë arsye prezenca e kryetarëve të komunave dhe drejtorëve të drejtorive është e domosdoshme gjatë zhvillimit të mbledhjeve të kuvendeve të komunave.

Të dhënat e mbledhura gjatë procesit të monitorimit të komunave lidhur me obligimin e kryetarëve të komunave për të raportuar para kuvendeve të komunave veçanërisht për gjendjen ekonomiko-financiare gjatë vitit 2016, tregojnë se gjatë kësaj periudhe ka pasur 101 raportime në 37 komuna, me përjashtim të Kryetarit të Komunës së Klokotit, i cili nuk ka raportuar asnjëherë gjatë kësaj periudhe. Figura në vijim paraqet rezultatet e matjeve të shkallës së përgjegjësisë së kryetarëve për të raportuar në kuvendin e komunës, si vijon:




Fig. 5. Numri i raportimeve të kryetarëve të komunave.

Indikatorët për këtë çështje flasin se shumica e kryetarëve kanë përmbushur këtë obligim ligjor për raportim. Numri i raportimeve njëkohësisht tregon edhe shkallën e aktivizimit të kuvendeve të komunave për të aplikuar mjete kontrolli ndaj kryetarit të komunës. Në këtë drejtim, kryetarët e Komunave të cilët kanë raportuar më tepër se dy herë për situatën ekonomiko-financiare dhe çështje tjera lidhur me investimin e mjeteve dhe realizimin e planeve investuese, pas kërkesës së parashtruar nga anëtarët e kuvendit të komunës janë si vijon: Shtime dhe Istog (6 raportime), Kaçanik, Skenderaj, Prishtinë, Deçan, Prizren, Junik, Mitrovicë Jugore dhe Suharekë (4 raportime), Mamushë, Pejë, Lipjan, Ferizaj (3 raportime). Këtë obligim ligjor nuk e ka përmbushur vetëm Kryetari i Komunës së Klokotit, përkundër kërkesës së anëtarëve të kuvendit të kësaj komune.

1.5. Takimet Publike me Qytetarë

Në nivelin e pushtetit lokal, pjesëmarrja e drejtpërdrejtë e qytetarëve gjatë zhvillimit të procesit të politikbërjes është mjaft e shprehur dhe është zgjeruar përmes mekanizmave të ndryshëm të paraparë me ligj. Instrumentet e pjesëmarrjes së qytetarëve në bërjen e politikave janë kritere të demokracisë së drejtpërdrejtë që plotësojnë demokracinë moderne e cila kryesisht identifikohet me qeverisjen nga të zgjedhurit. Duke marrë parasysh nevojën e komunikimit të vazhdueshëm me qytetarë për marrjen e pikëpamjeve të tyre gjatë procesit të politikbërjes dhe qeverisjes, komunat kanë disa mundësi përmes normave të detyrueshme ligjore, që të sigurojnë pjesëmarrjen e qytetarëve në takimet e drejtpërdrejta, komitetet konsultative, informimin publik, qasjen në dokumentet zyrtare, si dhe metoda të tjera shtesë që i kontribuojnë transparencës dhe avancimit të qeverisjes lokale.

Të dhënat e mbledhura për rezultatet e komunave në përfshirjen e qytetarëve përmes takimeve publike japin një informacion për peshën e demokracisë lokale në komuna. Më poshtë janë prezantuar të dhënat për takimet publike në komuna të thirrura sipas nenit 68.1 të LVL-së, si vijon:




Fig. 6. Numri i takimeve publike gjithëpërfshirëse në komuna

Nga se vërejmë në figurën e mësipërme, gjatë periudhës raportuese, në 32 komuna janë mbajtur gjithsej 64 takime publike me qytetarë. Ndërsa, 6 komuna përfshirë: Fushë-Kosovën, Mitrovicën Veriore, Leposaviqin, Zveçanin, Zubin Potokun dhe Klllokotin, nuk kanë mbajtur asnjë takim publik me qytetarë sipas nenit 68.1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale. Veç këtyre takimeve, komunat kanë mbajtur takime të tjera shtesë me qytetarë, në vendbanime të caktuara dhe për çështje të ndryshme duke përfshirë: diskutimet buxhetore, planet hapësinore në nivel lokal, propozim-aktet e obligueshme për diskutim publik, si dhe takime të tjera të vlerësuara nga komunat.

Sipas të dhënave në 32 komuna janë mbajtur 311 konsultime publike për shqyrtimin e draft akteve komunale.

Konsultimet publike me qytetarë për projekt-akte komunale




Fig. 7. Numri i konsultimeve publike për projekt-aktet e komunave

Siç vërejmë nga figura e mësipërme, 6 komuna (Malishevë, Viti, Mamushë, Leposaviq, Skenderaj dhe Zveçan) nuk ka mbajtur asnjë konsultim publik shtesë.

Sa u përket dëgjimeve buxhetore, gjatë periudhës raportuese në 31 komuna janë mbajtur 200 dëgjime publike për planifikimin e buxhetit. Ndërsa në 7 komuna (*Mamushë, Partesh, Mitrovicë Veriore, Leposaviq, Ranillug, Gjakovë dhe Zveçan*) nuk kanë mbajtur dëgjime publike buxhetore.

Përkundër faktit se komunat kanë proklamuar të drejtën për pjesëmarrje, prezenca e qytetarëve në tubimet publike nuk ka dhënë interesim të dëshiruar, për çka ende ka hapësirë për veprim për të rritur përmasat e pjesëmarrjes, si dhe rritur cilësinë e diskutimit. Ndryshe nga praktikat e deritanishme, komunat duhet të zhvillojnë forma më praktike të konsultimeve publike, duke shfrytëzuar variacione më të përshtatshme, posaçërisht përmes teknologjisë informative. Njëkohësisht është e domosdoshme që qytetarët të njihen çdo herë me rezultatet e konsultimeve publike.

1.6. Aktet komunale

Vendimarrja është pjesë mjaft e rëndësishme e nivelit lokal të qeverisjes. Kuvendet e Komunave janë të mandatuara për të miratuar vendime të cilat përfaqësojnë interesat e përgjithshme të qytetarëve dhe në pajtim me legjislacionin në fuqi. Kuvendet miratojnë Statutin dhe Rregulloren e punës së Kuvendit, vendime, rregullore dhe aktet tjera të përgjithshme, miratojnë buxhetet e komunave, themelojnë komitetet e përhershme, komitete konsultative dhe komitete të tjera, si dhe akte tjera të nevojshme për funksionimin efikas të komunës. Kriteret dhe procedurat e vendimarrjes janë mjaft të rëndësishme dhe kërkohen të jenë në pajtim me parimet kryesore siç është: kushtetutshmëria dhe ligjshmëria, efikasiteti dhe efektiviteti, mosdiskriminimi, transparenca, interesit publik, si dhe parimeve të tjera të cilat sigurojnë një qeverisje të mirë dhe efektive. Mbikëqyrja e komunave në këtë pjesë është shtrirë në drejtim të sigurimit të ligjshmërinë gjatë procedurave vendimmarrëse dhe shqyrtimit të përmbajtjes së akteve të miratuara nga kuvendet e komunave.

Shikuar nga aspekti kuantitativ, gjatë vitit 2016 kuvendet e komunave kanë miratuar gjithsej 148 rregullore dhe 1678 vendime. Akte e miratuara janë të ndryshme, përfshirë: ato të natyrës financiare (miratimi i buxhetit, miratimi i kornizës afatmesme buxhetore, kornizën afatmesme të shpenzimeve, akte për bartjen e mjeteve financiare nga viti fiskal paraprak në vitin 2016), mjedisore, ekonomike, arsimit, sociale, urbanistike etj.

Numri i akteve të miratuara

148 Rregullore

1678 Vendime

1.7. Shqyrtimi i ligjshmërisë së akteve komunale

MAPL është autoriteti mbikëqyrës i ligjshmërisë së akteve të komunave, nëse përgjegjësia për mbikëqyrjen e tyre nuk i është dhënë me ligj ndonjë ministrie përgjegjëse apo institucioni që ka të bëjë me lëmi të posaçme. Ndërsa, shqyrtimi i kompetencave të deleguara ushtrohet nga organi i qeverisë qendrore që i ka deleguar. Me qëllim të lehtësimit të mbikëqyrjes dhe krijimit të një sistemi më efikas në këtë drejtim, për të realizuar shqyrtimin e ligjshmërisë së akteve komunale është miratuar Rregullorja (QRK) NR-01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe me këtë është shfuqizuar Vendimi Nr. 2/119 e qeveris i datës 7 Prill 2010.

Gjatë kësaj periudhe, komunikimi mes komunave dhe organit mbikëqyrës, përkatësisht Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal ka qenë i rregullt, dërgimi i akteve të kuvendit të komunës ka qenë i rregullt dhe në afatin e përcaktuar ligjor.

Nga gjithsej 1826 akte të miratuara nga kuvendet e komunave, MAPL ka bërë vlerësimin e ligjshmërisë së 810 akteve, ndërsa në ministri të linjës janë dërguar 1016 akte të komunave për vlerësim të ligjshmërisë. Gjatë procesit të vlerësimit të ligjshmërisë MAPL ka konstatuar ligjshmërinë e 872 akteve, kurse 38 akte janë vlerësuar si të kundërligjshme.

1.7.1. Veprimet për harmonizimin e akteve të kundërligjshme nga komunat

Pas marrjes së shkresave nga organi mbikëqyrës komunat i kanë harmonizuar 18 akte konform kërkesës për rishqyrtim të dërguar nga MAPL. Ndërsa 20 shkelje ende nuk janë harmonizuar në përputhje me kërkesën e organit mbikëqyrës, nga komunat: Kamenica (1), Ranillugu (1), Graçanica (4), Gjakova (2), Zubin Potok (1), Glogovc (1), Dragash (1), Deçan (1), Novobërdë (1), Obiliq (1), Malishevë (2), Klllokot (3).

Në vijim janë paraqitur figurat me shkeljet ligjore në komuna dhe veprimet e tyre për harmonizimin e akteve të kundërligjshme:




Fig.8. Numri i akteve të kundërligjshme dhe të harmonizuara sipas komunave



Fig. 9. Numri i akteve të kundërligjshme të paharmonizuara sipas komunave

Shkeljet e konstatuara dhe aktet e rishqyrtuara




Fig.10. Numri i përgjithshëm i shkeljeve të konstatuara

Shkeljet ligjore të komunave të identifikuara nga MAPL dhe për të cilat ka adresuar kërkesat për rishqyrtim, kryesisht kanë të bëjnë me: procedurat e dhënies së pronës komunale në shfrytëzim (kryesisht për rastet e ndarjes së pronës për ndërtim individual të banimit), këmbimin e pronës komunale, ndërtimit të objekteve fetare, procedurave për bashkëpunim ndërkomunal, emërimin e anëtarëve në komitetet e obligueshme, kushtëzimin e qytetarëve më kryerjen e obligimeve për shërbimet komunale, etj.

Më detajisht, në Shtojcën 1 dhe 2 janë paraqitur tabelat e shkeljeve ligjore në komuna si dhe veprimet e ndërmarra nga komunat lidhur me kërkesat për rishqyrtim.

1.8. Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi

Në nivelin lokal, trupa me rëndësi për sigurinë publike të qytetarëve por edhe më gjerë janë Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi (KKSB). Themelimi i KKSB-së bazën ligjore e ka në Ligjin për Policinë, ndërsa procedurat e themelimit, përbërja, mënyra e funksionimit dhe obligime të tjera janë përcaktuar me Udhëzimin Administrativ Nr.27/2012 MPB – 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi.



Në vitin 2014 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka miratuar edhe Manualin për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, përmes të cilit dokument është synuar të rrisim vetëdijen e zyrtareve komunal për ndikimin e instrumenteve të kontrollit formal dhe joformal shoqëror për të krijuar një ambient të qetë dhe të sigurt për qytetarët. Këshilli komunal për siguri në bashkësi është themeluar në 34 komuna, ndërsa nuk është themeluar në Komunitat: Leposaviq, Mitrovicë Veriore, Zveçan dhe Zubin Potok.

Sa i kriterëve për mbajtjen e takimeve, me Udhëzimin Administrativ për KKSB ndër të tjera është rregulluar edhe numri minimal prej gjashtë takimeve në vit, tri prej të cilave duhet të mbahen në gjashtëmujorin e parë. Nga ky aspekt, më aktiv ka qenë Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi në komunën e Hanit të Elezit me gjithsej 12 takime të mbajtura, 7 takime ka mbajtur në komunat: Mitrovicë Jugore, Viti dhe Dragash, nga 6 takime kanë mbajtur KKSB në Komunitat: Pejë, Prizren, Deçan, Obiliq, Malishevë, Vushtrri, Rahovec, Ferizaj, Kaçanik, Podujevë, Gjakovë, Suharekë, Glogoc, Shtërpçë, dhe Ranillug, nga 5 takime KKSB ka mbajtur në Komunitat: Klinë, Istog, Shtime, Kamenice, Skenderaj, Partesh dhe Novobërdë, nga 4 takime ka mbajtur në: Lipjan, Junik, Mamushë, 3 takime KKSB ka mbajtur në komunën e Gjiçanit, dhe Graçanicës, një takim KKSB ka mbajtur në Komunën e Prishtinës. Krahas këtyre, KKSB-të e komunave: Fushë Kosovë dhe Klokot nuk kanë mbajtur asnjë takim në periudhën raportuese.

Të dhënat për numrin e takimeve të KKSB-së, janë paraqitur në figurën në vijim:

KKSB




Fig. 11. Takimet e këshillave komunale për siguri në bashkësi

Nga pasqyrimi i mësipërm i mbledhjeve të KKSB-së, shihet se 19 Komuna të Republikës së Kosovës kanë mbajtur numrin minimal të mbledhjeve ashtu siç është përcaktuar në Udhëzimin Administrativ për KKSB, 13 komuna janë nën minimumin e përcaktuar, Komuna e Prishtinës me vetëm 1 takim, Fushë Kosova me asnjë takim të mbajtur, derisa në 4 komuna mbetet sfida themelimi i tyre.

Duke marrë parasysh fushëveprimin e këtyre këshillave, gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2016, temat dhe problemet kryesore më të trajtuara nga këto këshilla kanë qenë:

- Siguria në shkolla (Vendosja e kamerave në shkolla)
- Qentë endacak;
- Lëmoshë kërkuesit;
- Siguria në trafik dhe shenjëzimi i rrugëve;
- Krijimi i kushteve për kthim të qëndrueshëm
- Pengimi dhe parandalimi i dhunës në familje
- Mungesa e nënkalimeve në rrugë veçanërisht afër shkollave
- Përdorimi i substancave narkotike
- Krimi dhe sjelljet e dhunshme
- Vërshimet
- Përdorimi i armëve në ahengje
- Mbrojtja e Pyjeve
- Kufizimi i orarit të punës gjatë natës nga lokaleve afariste hoteliere
- Inspektimi i shitësve ambulant
- Ekstremizmi fetar.

Sa u përket iniciativave për realizimin e projekteve për siguri në bashkësi gjatë vitit 2016, janë të planifikuara këto projekte të cilat kanë dalë si propozim takimet e KKSB-së:

- Iniciativa për vendosjen e shenjave të komunikacionit
- Vendosja e kamerave në shkolla
- Vendosja e kamerave në qytet
- Ndriçimi publik

- Rregullimi dhe aktivizimi i sistemit të detektimit të zjarrit në objektet e administratës
- Rregullimi dhe vënia në funksion e sistemit të alarmit publik të banorëve të komunës
- Rregullimi i pajisjeve ekzistuese dhe furnizimi i konsiderueshëm me pajisje të reja kundër zjarrit në institucionet që financohen përmes buxhetit të Komunës
- Kontrollimi i zonave të dyshimta për mjete shpërthyes
- Asfaltimi i rrugëve
- Vendosja e kanalizimeve
- Pastrimi i mbeturinave
- Adaptimi i kushteve për të kthyerit
- Kastrimi i qenve endacak
- Parandalimi i substancave narkotike.

Sfidat më të shpeshta me të cilat ballafaqohen komunat në çështjet e sigurisë janë:

- Gjetja e fondeve për realizimin e projekteve të propozuara nga KKSB
- Pagesa e anëtarëve të KKSB-së
- Ndotja e Ambientit
- Vendosja e nënkalimeve në rrugët kryesore sidomos afër shkollave
- Siguria në trafik

2. Agjenda Evropiane



Republika e Kosovës tani më ka hyrë në një kapitull të rëndësishëm të proceseve integruese me Bashkimin Evropian. Në pajtim me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit (MSA) të nënshkruar nga Republika e Kosovës dhe Bashkimi Evropian, e cila ka hyrë në fuqi më 1 prill 2016, si dhe Programin Kombëtar për zbatim të MSA-së të aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 10 mars 2016, MAPL ka ndërmarrë veprime për adresimin dhe zbatimin e obligimeve të komunave në kuadër të

tri kritereve kryesore: politike, ekonomike dhe standardeve evropiane. Në mënyrë të veçantë janë përgatitur matricat individuale të komunave nga obligimet e agjendës evropiane, duke përfshirë: Dialogun për Procesin e Stabilizim Asociimit dhe PKZMSA-në dhe sfidat nga Raporti i KE-së për Kosovën (pjesa e sfidave të komunave), mbi bazën e së cilave janë ofruar të dhënat në këtë kapitull.

2.1. Vlerësim i përgjithshëm i përmbushjes së obligimeve të komunave

Lidhur me obligimet e dala nga agjenda evropiane, komunat kanë arritur të përmbushin 78% të aktiviteteve të parapara në fushën e kritereve politike. Sa i përket kritereve ekonomike, komunat kanë përmbushur 75% të aktiviteteve të parapara, ndërsa në fushën e standardeve evropiane, komunat kanë realizuar 68% të aktiviteteve. Niveli i përgjithshëm i përmbushjes së obligimeve të komunave nga agjenda evropiane për vitin 2016 është 73%.

2.1. Kriteret politike

2.1.1. Administrata publike

Trajnimet për zyrtarët komunal – Në 31 komuna është hartuar programi i trajnimeve për shërbyesit civil, kurse 7 komuna (Mamushë, Malishevë, Partesh, Kamenicë, Gjakovë, Klinë dhe Leposaviq) nuk e kanë hartuar këtë program. Në 36 komuna janë mbajtur 825 trajnime për zyrtarët komunal, ose mesatarisht 23 trajnime për komunë. Ndërsa, Komuna e Junikut dhe Ranillugut nuk kanë marrë pjesë në trajnimet e organizuara për forcimin e kapaciteteve të administratës komunale.

Numri i trajnimeve dhe zyrtarëve të trajnuar




Fig.12. Trajnimet e mbajtura dhe numri i zyrtarëve të trajnuar në komuna

Sipas figurës së mësipërme, vërejmë se në 36 komuna janë trajnuar gjithsej 1506 zyrtarë komunal, apo mesatarisht 42 zyrtarë të trajnuar për çdo komunë në fushat përkatëse profesionale.

Katalogu i vendeve të punës - Të gjitha komunat kanë përgatitur Katalogun e vendeve të punës për Shërbimin Civil, me përjashtim të Komunës së Leposaviqit.

Transparenca dhe qasja në dokumentet zyrtare - Me qëllim të rritjes së nivelit të transparencës dhe rritjes së pjesëmarrjes së shoqërisë civile në vendimmarrje, në 17 komuna janë mbajtur 91 fushata vetëdijësuese për qytetarë lidhur me ofrimin e shërbimeve publike komunale. Për dallim nga kjo, 21 komunat: Klinë, Skenderaj, Pejë, Junik, Rahovec, Shtërpçë, Leposaviq, Graçanicë, Mamushë, Lipjan, Mitrovicë Veriore, Kaçanik, Partesh, Zubin Potok, Ranillug, Klllokot, Fushë Kosovë, Viti, Kamenicë, Hani Elezi dhe Zveçan, nuk kanë mbajtur ndonjë fushatë të tillë.

Duhet shtuar se gjatë kësaj periudhe, në 35 komuna janë paraqitur 963 kërkesa për qasje në dokumentet publike, ndërsa në 3 komunat: Junik, Zveçan dhe Zubin Potok, nuk kanë pasur kërkesa të tilla.

Numri i kërkesave për qasje në dokumentet publike




Fig.13. Numri i kërkesave për qasje në dokumente publike sipas komunave

Përdorimi i gjuhëve zyrtare - Lidhur me respektimin e gjuhëve zyrtare në komuna, 31 komuna kanë publikuar në ueb-faqen e tyre aktet e nxjerra nga organet e komunës në gjuhët zyrtare. Krahas tyre, 3 komuna (*Mamushë, Malishevë dhe Podujevë*) aktet i kanë publikuar pjesërisht, kurse 4 komuna (*Leposaviq, Mitrovicë Veriore, Partesh dhe Zubin Potok*) nuk kanë siguruar publikimin e tyre.

Rregullorja për përdorimin e gjuhëve është e aprovuar në 34 komuna, ndërsa 4 komunat: Mitrovicë Veriore, Ranillug, Zveçan dhe Leposaviq, ende nuk i kanë hartuar këto rregullore. Po ashtu, 28 komuna kanë ndërmarrë veprime për të krijuar qasje për shërbime në gjuhët zyrtare në nivel komunal, përkatësisht kanë siguruar që të ketë përkthyes, dokumentet të përkthehen në gjuhët zyrtare, të sigurojnë publikimin e informative në ueb-faqet e komunës dhe në gjuhë zyrtare, etj. Për dallim nga këto, 10 komunat: Junik, Leposaviq, Malishevë, Mamushë, Zubin Potok, Novobërdë, Ranillug, Klllokot, Zveçan dhe Hani Elezit, nuk kanë ndërmarrë ndonjë veprim të tillë.

Qendrat për shërbim të qytetarëve – këto qendra janë themeluar në 36 komuna, ndërsa nuk janë themeluar në Komunën e Zveçanit dhe Leposaviqit. Gjithashtu, procesi i funksionalizimit të

administratës komunale ka filluar në 4 komuna: Mitrovicë Veriore, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan.

Përfshirja e komuniteteve joshumicë - Shumica e komunave të vendit kanë ndërmarrë veprime konkrete për përfshirjen e minoriteteve në institucionet lokale. Gjatë kësaj periudhe masa të përfshirjes kanë ndërmarrë 27 komuna, ndërsa 7 komunat: Rahovec, Leposaviq, Mamushë, Partesh, Zubin Potok, Shtime dhe Ranillug, nuk kanë ndërmarr ndonjë veprim përkatës. Duhet shtuar se në 4 komuna: Hani Elezit, Junik, Kaçanik dhe Gllogoc, nuk jetojnë pjestarë të komuniteteve jo shumicë.

Në bazë të dhënave, 20 komuna kanë ndarë buxhet për vitin 2016 për mbështetjen e komuniteteve pakicë në vlerë prej 1,122,401.00 euro, ndërsa 14 komuna: *Deçan, Shtërpçë, Leposaviq, Mamushë, Mitrovicë Veriore, Partesh, Zubin Potok, Novobërdë, Ranillug, Obiliq, Suharekë, Klllokot, Zveçan dhe Podujeva*, nuk kanë ndarë buxhet të veçantë për këtë qëllim.

Përfshirja e komuniteteve joshumicë në nivel lokal




Fig.14. Numri i të punësuarve nga radhët e komuniteteve sipas komunave

Numri i të punësuarve nga radhët e pjesëtarëve të komuniteteve minoritare në administratën publike në 32 komuna është 1402, ndërsa 6 komuna: Obiliq, Kaçanik, Zubin Potok Junik, Gllogoc dhe Hani Elezit, nuk kanë të punësuar pjesëtarë të komuniteteve joshumicë.

2.1.2. Avokati i Popullit

Gjatë periudhës raportuese, 11 komuna kanë pranuar 35 kërkesa/rekomandime nga Institucioni i Avokatit të popullit, ndërsa 27 komuna: Deçan, Dragash, Gjiilan, Istog, Mamushë, Prizren, Lipjan, Kaçanik, Mitrovicë Veriore, Partesh, Kamenicë, Klllokot, Hani Elezit, Ferizaj, Novobërdë, Vushtrri, Shtime, Ranillug, Klinë, Leposaviq, Rahovec, Pejë, Skenderaj, Shtërpçë, Junik, Zubin Potok dhe Zveçan, nuk kanë pranuar asnjë kërkesë apo rekomandim nga ky institucion.

Kërkesat e Avokatit të Popullit




Fig. 15. Paraqitja e nivelit dhe procesit të kërkesave të Avokatit të Popullit sipas komunave

Sa i përket shqyrtimit të kërkesave, 9 komuna kanë kthyer 16 përgjigje pozitive, ndërsa komuna e Prishtinës dhe Obiliqit kanë kthyer 2 përgjigje negative. Gjithashtu, 6 komuna: Gjakovë, Glllogoc, Prishtinë, Mitrovicë, Obiliq dhe Graçanicë, janë në proces të shqyrtimit të 14 kërkesave/rekomandimeve.

Qasja e personave me aftësi të veçanta në institucionin e avokatit të popullit - Kujdes i veçantë i është kushtuar qasjes së gjithë qytetarëve në këto zyra. Sipas të dhënave, në 4 komuna: Prishtinë, Prizren, Ferizaj dhe Gjiilan, hapësirat e punës së institucionit të Avokatit të Popullit në institucionet lokale janë të qasshme në aspektin fizik edhe për personat me aftësi të veçanta. Krahas tyre, në 3 komuna: Pejë, Graçanicë dhe Mitrovicë, hapësirat e punës së institucionit të Avokatit të Popullit janë të qasshme pjesërisht, ndërsa në komunën e Mitrovicë Veriore dhe Gjakovës, nuk janë krijuar kushtet e domosdoshme për qasjen e kësaj kategorie.

2.1.3. Shoqëria Civile

Me qëllim të përkrahjes së aktiviteteve të OJQ-ve, 26 komuna kanë financuar 705 projekte të OJQ-ve në vlerë totale prej 2,668,942.99€. Krahas tyre, 12 komunat: Shtërpçë, Leposaviq, Dragash, Mamushë, Mitrovicë Veriore, Partesh, Zubin Potok, Gjiilan, Novobërdë, Ranillug, Klllokot dhe Hani Elezit, nuk kanë pasur projekte të realizuara.

2.1.4. Lufta Kundër Korrupsionit

Deklarimi i pasurisë - Numri i personave zyrtar që deklarojnë pasurinë në 38 komuna është 1619. Numri më i madh i zyrtarëve që obligohen të deklarojnë pasurinë është në Komunën e Prishtinës me gjithsej 76 zyrtarë të lartë publik. Ndërsa, komunat me më së paku zyrtarë të lartë publik të obliguar për deklarimin e pasurisë janë: Parteshi dhe Klllokoti, me nga 25 zyrtarë.

Konflikti i interesit - Gjatë periudhës raportuese, në 35 komuna nuk ka pasur ndonjë rast të deklarimit të konfliktit të interesit nga zyrtarët komunal apo anëtarët e Kuvendeve të Komunave. Ndërsa në 3 komuna: Mitrovicë, Lipjan dhe Zveçan, ka pasur 4 raste të paraqitjes së konfliktit të interesit në organet komunale.

Plani i veprimit komunal kundër korrupsionit – Këtë plan e kanë hartuar vetëm 12 komuna, ndërsa komunat të cilat nuk e kanë hartuar janë: Deçan, Graçanicë, Klinë, Pejë, Junik, Shtërpçë, Rahovec, Leposaviq, Dragash, Mamushë, Prishtinë, Prizren, Malishevë, Mitrovicë Veriore, Kaçanik, Zubin Potok, Partesh, Suharekë, Shtime, Novobërdë, Ranillug, Klokot, Viti, Zveçan, Kamenicë dhe Hani Elezit.

2.1.5. Riintegrimi dhe Ripranimi

Në 33 komuna është përmirësuar niveli organizativ dhe janë rritur kapacitetet profesionale të Zyrrave Komunale për Komunitete dhe Kthim për menaxhimin e procesit të ri-integrimit, ndërsa 5 komunat: Klinë, Shtërpçë, Rahovec, Vushtrri dhe Leposaviq, nuk kanë shënuar ndonjë progres në këtë drejtim.

2.1.6. Të Drejtat e Njeriut dhe Mbrojtja e Minoriteteve

Promovimi i të drejtave të njeriut - Në 22 komuna janë mbajtur 189 aktivitete për të drejtat e njeriut për trajtimin e temave të ndryshme, si: barazia gjinore, të drejtat trashëgimore, të drejtat e fëmijëve, kundërdiskriminimi, etj. Krahas tyre, 16 komunat: Deçan, Gjiilan, Kaçanik, Leposaviq, Novobërdë, Skenderaj, Shtime, Shtërpçë, Zveçan, Hani Elezit, Mamushë, Junikë, Klokot, Graçanicë, Ranillug dhe Partesh, nuk kanë ndërmarrë ndonjë aktivitet në këtë fushë. Më së shumti aktivitete në këtë fushë kanë mbajtur Komuna e Prizrenit dhe Kamenicës, me gjithsej 36 aktivitete.

Trajnimet për të drejtat e njeriut – Sipas të dhënave, në 28 komuna janë organizuar 101 trajnime për fushën e të drejtave të njeriut, kurse 10 komunat: Gjakovë, Kaçanik, Leposaviq, Novobërdë, Shtërpçë, Hani Elezit, Mamushë, Junik, Graçanicë dhe Zveçan, nuk kanë organizuar ndonjë trajnim. Fusha për të drejtat e njeriut ka qenë pjesë e programit të trajnimeve për shërbyesit civil në 24 komuna, ndërsa në 14 komuna nuk është përfshirë (Rahovec, Leposaviq, Graçanicë, Mamushë, Prishtinë, Lipjan, Mitrovicë Veriore, Prizren, Kaçanik, Gjakovë, Klokot, Fushë Kosovë, Hani Elezit dhe Kamenicë).

Rregullorja komunale për të drejtat e fëmijëve – Kjo rregullore është hartuar në 19 komuna, ndërsa nuk është hartuar në komunat: Dragash, Mamushë, Lipjan, Prishtinë, Prizren, Mitrovicë Veriore, Partesh, Novobërdë, Ranillug, Klokot, Mitrovicë, Deçan, Rahovec, Junik, Shtërpçë, Leposaviq, Graçanicë, Zubin Potok dhe Zveçan.

Databaza për raportimin e dhunës mbi baza gjinore - Sa i përket sistemit uniform të bazës së të dhënave mbi rastet e dhunës në baza gjinore, 21 komuna e kanë krijuar databazën e veçantë për mbledhjen e të dhënave, ndërsa 17 komuna: Pejë, Junik, Graçanicë, Leposaviq, Dragash, Mamushë, Malishevë, Kaçanik, Partesh, Suharekë, Gjakovë, Gjiilan, Ranillug, Fushë Kosovë, Zveçan, Hani Elezit dhe Kamenicë, nuk kanë krijuar një sistem të tillë.

Përfaqësimi i femrave në institucionet lokale - Numri i përfaqësimit të femrave në pozita menaxheriale në 35 komuna është 427. Numri i përfaqësimit të femrave në komuna, duke përfshirë administratën dhe Kuvendin e Komunës është 2483.

Përfaqësimi i femrave në institucionet lokale




Fig.16. Niveli i përfaqësimit të femrave të punësuar në organet e komunave

Ndërsa 3 komuna: Leposaviq, Dragash dhe Partesh, nuk kanë përfaqësim të femrave në pozita menaxheriale.

2.1.7. Mbrojtja dhe Promovimi i Trashëgimisë Kulturore

Planet për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore – Këto plane janë hartuar në 15 komuna, ndërsa në 23 komuna ende nuk janë hartuar (Dragash, Lipjan, Mamushë, Prishtinë, Prizren, Mitrovicë Veriore, Partesh, Ferizaj, Shtime, Novobërdë, Pejë, Ranillug, Klokot, Kamenicë, Mitrovicë, Klinë, Pejë, Skenderaj, Shtërpçë, Leposaviq, Graçanicë, Zubin Potok dhe Zveçan).

Zonat e mbrojtura – Gjatë kësaj periudhe, në 7 komuna ka pasur 34 raste të shkeljeve në zonat e mbrojtura, si në: Klinë, Novobërdë, Ranillug, Gjakovë, Rahovec, Prizren dhe Ferizaj. Në 31 komunat e tjera nuk ka pasur ndonjë rast të paraqitur për shkelje të tilla. Komunat të cilat kanë evidentuar raste të shkeljeve të tilla, kanë ndërmarrë procedurat për ngritjen e kallëzimeve penale ndaj kryerësve.

Masat mbrojtëse për trashëgiminë kulturore – Në 15 komuna janë vendosur pajisjet për monitorimin e sigurisë (instalimi i kamerave) të tërësive të trashëgimisë kulturore të Kishës Ortodokse, ndërsa në 16 komuna: Shtërpçë, Leposaviq, Prishtinë, Lipjan, Mitrovicë Veriore, Partesh, Zubin Potok, Suharekë, Obiliq, Shtime, Ranillug, Mitrovicë, Zveçan, Klokot, Viti dhe Kamenicë, ende nuk janë vendosur këto pajisje. Krahës tyre, në 7 komuna: Junik, Glllogoc, Dragash, Mamushë, Malishevë, Novobërdë dhe Hani Elezit, nuk ka kisha ortodokse.

Këshilli për Fshatin Hoqë e Madhe dhe Task-Forca për Qendrën Historike të Prizrenit - Këshilli i fshatit Hoqë e Madhe funksionon me vendim të kuvendit të komunës së Rahovecit që prej vitit 2015. Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2016, është bërë rrënimi i një objekti të vjetër me qëllim të lirimit të hapësirës të monumentit “Sarajë” dhe hapësirës së gjelbër. Gjithashtu, është bërë largimi i deponive të egra dhe ndërtimi i rrjetit të kanalizimit. Buxheti për fshatin Hoqë e Madhe është 18.500 €.

Në Komunën e Prizrenit, janë siguruar të gjitha fondet dhe materialet për Këshillin e Trashëgimisë Kulturore për Qendrën Historike të Prizrenit. Në këtë drejtim, Komuna e Prizrenit ka alokuar buxhetin në vlerë prej 57,000€ për Këshillin e Trashëgimisë Kulturore të Prizrenit. Gjatë kësaj periudhe Komuna e Prizrenit ka ndërmarrë veprime të nevojshme administrative për përfshirjen e këtij Këshilli gjatë procedurave të dhënies të lejeve ashtu siç parashihet me Ligjin për Qendrën Historike të Prizrenit. Gjithashtu, janë shqiptuar 10 gjoba mandatore, 2 kërkesa për procedura të kundërvajtjes dhe 8 kallëzime penale në Prokurorinë Themelore në Prizren. Përveç kësaj, Komuna e Prizrenit ka caktuar 4 inspektorë për inspektimin e ndërtimeve ilegale brenda Zonave të Veçanta të Mbrojtura në Komunën e Prizrenit. Task Forca ka bërë identifikimin e objekteve të cilët janë ndërtuar në kundërshtim me Ligjin për Qendrën Historike, dhe si rezultat 10 raste janë në procedurë.

2.2. Kriteret Ekonomike

2.2.1. Ekonomia e tregut

Procedurat administrative - Gjatë periudhës raportuese, 29 komuna kanë ndërmarrë veprime me qëllim të lehtësimit të procedurave dhe zvogëlimit të barrierave administrative komunale për të bërit biznes, përfshirë edhe uljen e taksave të ndryshme për biznese, si dhe dhënien e subvencioneve. Komuna e Mamushës dhe Parteshit ende nuk kanë të themeluar zyrën për regjistrim të biznesit. Sipas të dhënave, në 33 komuna numri i bizneseve të reja të regjistruara është gjithsej 6731. Ndërsa, në 32 komuna, numri i bizneseve të mbyllura gjatë periudhës raportuese është 1984. Në Komunën e Novobërdës gjatë kësaj periudhe nuk është mbyllur asnjë biznes, kurse 5 komuna (Prishtinë, Partesh, Leposaviq, Kllokot dhe Mamushë) nuk kanë ofruar të dhëna për këtë çështje.

Ndarja e subvencioneve për biznese - Sa i përket ndarjes së buxhetit të veçantë për subvencionimin e bizneseve, është raportuar se 14 komuna kanë ndarë buxhet për këtë qëllim, ndërsa 24 komuna (Deçan, Klinë, Rahovec, Pejë, Skenderaj, Junik, Shtërpçë, Leposaviq, Dragash, Mamushë, Lipjan, Mitrovicë Veriore, Partesh, Zubin Potok, Suharekë, Shtime, Obiliq, Vushtrri, Novobërdë, Ranillug, Istog, Podujevë, Hani Elezit dhe Kllokot) nuk kanë ndarë buxhet.

Qendrat për promovimin e bizneseve - Në 19 komuna janë funksionale Qendrat për promovimin e bizneseve, ndërsa në 19 komuna (Klinë, Pejë, Skenderaj, Junik, Leposaviq, Prizren, Malishevë, Kaçanik, Mitrovicë Veriore, Mamushë, Partesh, Zubin Potok, Ferizaj, Gjakovë, Vushtrri, Obiliq, Ranillug, Istog dhe Zveçan) nuk janë funksionalizuar ende.

Lehtësimi dhe digjitalizimi i shërbimeve - Me qëllim të modernizimit të mbledhjes së të hyrave komunale, duke përfshirë mbledhjen e tatimit në pronë, gjatë periudhës raportuese 30 komuna kanë ndërmarrë veprimet, si vijon: realizimi i kontratave me PTK-në për shpërndarje të faturave, lansimi i sistemit PROTAX 1 për gjenerim të faturave, krijimi i qasjes online në faturat për tatimin në pronë, hapja e zyrave për projektim dhe këshillim, aplikacioni për menaxhimin e kërkesave ndaj shërbimit të IT-së, aplikacioni për monitorimin e serverëve, ndërrimin e E-pasurisë, si dhe modifikimi i intranet-arkës. Ndërsa 9 komuna: Skenderaj, Mamushë, Partesh, Gjakovë, Ranillug, Kllokot, Hani Elezit, Leposaviq dhe Shtërpçë, nuk kanë pasur ndonjë të arritur.

2.3. Standardet Evropiane

2.3.1. “One-Stop Shop

Themelimi dhe funksionalizimi i “one-stop shop” apo pikave të përbashkëta administrative në komuna për ofrimin e shërbimeve të bizneseve lokale, ka vazhduar edhe në komunat me shumicë serbe. Këto pika pritet të themelohen edhe në 9 komuna tjera, si në: *Graçanicë, Leposaviq, Istog, Zveçan, Kllokot, Mamushë, Prishtinë, Novobërdë dhe Ranillug*. Me qëllim të funksionimit sa më të mirë të këtyre pikave komunale, 14 komuna kanë organizuar trajnime për 93 zyrtarë, ndërsa 28 komuna (Mamushë, Prishtinë, Prizren, Malishevë, Kaçanik, Shtime, Deçan, Glogoc, Klinë, Rahovec, Pejë, Skenderaj, Junik, Graçanicë, Leposaviq, Shtërpçë, Kamenicë, Viti, Kllokot, Istog, Zveçan, Zubin Potok, Ferizaj, Novobërdë, Suharekë, Gjilan, Ranillug dhe Hani Elezit) nuk kanë organizuar ndonjë trajnim.

2.3.2. Shoqëria e Informacionit dhe Mediat

Në 37 komuna ka shtrirje të internetit në të gjitha institucionet publike, përfshirë: Shkollat, Ambulancat, Zyret e Vendi, ndërsa në Komunën e Leposaviqit nuk ka shtrirje të internetit në të gjitha institucionet.

2.3.3. Transporti

Sa i përket rrugëve lokale në komuna, vërehet një progres, të cilin e kemi paraqitur si në diagramin e mëposhtëm, si vijon:




Fig.17. Përqindja e rrugëve lokale të asfaltuara sipas komunave

Në kuadër të fushës së transportit, komunat e vendit i kanë kushtuar prioritet asfaltimit të rrugëve lokale dhe riparimit të tyre. Sipas të dhënave të raportuara nga 35 komuna, është arritur që të asfaltohen 73% të rrugëve lokale në gjithë vendin. Sa i përket mirëmbajtjes së rrugëve, sipas të dhënave të raportuara nga 27 komuna, 59% të rrugëve komunale janë të sinjalizuara, 50% e rrugëve janë të shtruara me trotuare dhe 60% e rrugëve janë të përfshira në planin e mirëmbajtjes.

2.3.4. Energjia

Sipas të dhënave 29 komuna e kanë hartuar Planin për Energji Efiçente, ndërsa 9 komuna nuk e kanë hartuar, duke përfshirë komunat: Mamushë, Mitrovicë Veriore, Skenderaj, Leposaviq, Ranillug, Klllokot, Hani Elezit, Graçanicë dhe Prishtinë. Në 16 komuna janë mbajtur trajnime në fushën e efiçencës së energjisë, kurse në 22 të tjera nuk janë organizuar këto trajnime, përfshirë komunat: Kaçanik, Klinë, Fushë Kosovë, Leposaviq, Lipjan, Novobërdë, Prizren, Shtime, Shtërpçë, Suharekë, Ferizaj, Viti, Vushtri, Zubin Potok, Zveçan, Hani Elezit, Mamushë, Junik, Graçanicë, Ranillug, Partesh dhe Mitrovicë Veriore. Sa u përket aktiviteteve të zbatuara në këtë fushë, në 25 komuna janë ndërmarrë veprimet si vijon: ndërrimi i poqeve të ndriçimit publik, vendosja e sistemit të poqeve LED në rrugët e qytetit, rregullimi i shkollave me sistem të energjisë efiçente etj. Ndërsa, 13 komuna (Suharekë, Vushtri, Ranillug, Mamushë, Mitrovicë Veriore, Partesh, Zubin Potok, Pejë, Skenderaj, Leposaviq, Shtërpçë, Klllokot dhe Hani Elezit) nuk kanë ndërmarrë ndonjë aktivitet konkret në këtë aspekt.

2.3.5. Gjyqësori dhe të drejtat themelore

Mbrojtja e të dhënave personale - Sa i përket fushës së mbrojtjes së të dhënave personale në komuna, vetëm në Komunën e Zubin Potokut nuk është caktuar zyrtari përkatës komunal për mbrojtjen e të dhënave personale. Në 22 komuna është funksionalizuar baza e të dhënave personale, ndërsa në 16 komuna (Mamushë, Kaçanik, Mitrovicë Veriore, Novobërdë, Gjilan, Gjakovë, Ranillug, Istog, Fushë Kosovë, Hani Elezit, Glogoc, Klinë, Skenderaj, Leposaviq, Zveçan dhe Graçanicë) nuk është funksionalizuar. Në 15 komuna janë mbajtur 30 trajnime për zyrtarin për mbrojtjen e të dhënave personale, ndërsa në 23 komuna (Gjakovë, Istog, Kaçanik, Klinë, Fushë Kosovë, Mitrovicë, Leposaviq, Lipjan, Novobërdë, Rahovec, Skenderaj, Shtime, Shtërpçë, Ferizaj, Vushtri, Zubin Potok, Hani Elezit, Mamushë, Junik, Klllokot, Graçanicë, Partesh dhe Mitrovicë Veriore) nuk është organizuar asnjë trajnim. Gjithashtu, sigurinë fizike të dokumentacionit, përkatësisht vendosjen e rojave fizike, kamerave, grilave, kasafortave, e kanë bërë 33 komuna, ndërsa në 5 komuna: Novobërdë, Gjakovë, Leposaviq, Fushë Kosovë dhe Zveçan, nuk është ndonjë veprim përkatës. Po ashtu, në 35 komuna mbahen edhe librat fizik, ndërsa në 3 komuna: Vushtri, Leposaviq, Fushë Kosovë nuk mbahen librat fizik.

Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim - Në kuadër të funksionimit të Zyrave komunale për komunitete dhe Kthim, në 37 komuna bëhet verifikimi i kërkesave të personave të riatdhesuar nga zyrtari për kthim dhe komunitete, si dhe lënda shqyrtohet në Komisionin Komunal për ri-integrimin e personave të riatdhesuar. Sa i përket Komunës së Leposaviqit, nuk është ofruar ndonjë informacion. Gjatë kësaj periudhe, ka pasur 1500 kërkesa për pajisje me dokumente personale nga personat e riatdhesuar.

Gjatë periudhës raportuese Janar - Dhjetor 2016, në 33 komuna numri i personave të rikthyer dhe të regjistruar është 8458, ndërsa në 5 komuna (Deçan, Shtime, Viti, Mamushë dhe Leposaviq) nuk ka pasur persona të rikthyer. Po ashtu, në 20 komuna numri i shtëpive të

rindërtuara për të rikthyerit është 138, ndërsa në 18 komuna (Deçan, Glogoc, Gjilan, Kaçanik, Leposaviq, Podujevë, Prishtinë, Shtime, Shtërpçë, Viti, Malishevë, Hani Elezit, Mamushë, Junik, Killokot, Graçanicë, Ranillug dhe Partesh) nuk ka shtëpi të rindërtuara për të rikthyerit.

Personat e zhvendosur dhe shtëpitë e rindërtuara




Fig.18. Numri i personave të rikthyer dhe shtëpitë e rindërtuara sipas komunave

Numri i aplikimeve për asistencë nga fondi për ri-integrim është 3044, kurse numri i aplikimeve për zhvillimin e bizneseve nga personat e riadhesuar është 1927. Përveq kësaj, në 6 komuna janë organizuar 49 kurse për fëmijët e riadhesuar.

Planet e veprimit për integrimin e komunitetit RAE – Shumica e komunave në të cilat jetojnë pjestarë të komunitetit RAE kanë miratuar Planet Lokale të Veprimit për Integrimin e këtij komuniteti, me përjashtim të 6 komunave: *Gjilan, Rahovec, Shtërpçë, Graçanicë, Leposaviq dhe Mitrovicë Veriore*. Në total janë 22 komuna të cilat e kanë hartuar këtë plan. 10 komuna të cilat nuk kanë pjestarë të komunitetit RAE janë: Ranillug, Dragash, Kaçanik, Hani Elezit, Killokot, Partesh, Zveçan, Zubin Potok, Glogoc, Junik. Numri total i personave të riadhesuar nga ky komunitet është 1503 në gjithsej 15 komuna.

Regjistrimi i personave nga komuniteti RAE




Fig.19. Numri i personave të regjistruar nga radhët e komunitetit RAE sipas komunave

2.3.5. Drejtësia, Liria dhe Siguria

Planet lokale të veprimit për riintegrim – janë të aprovuara në 35 komuna, me përjashtim të 3 komunave: *Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan*.

Digjitalizimi i librave të gjendjes civile - Në 18 komuna është përfunduar procesi i digjitalizimit të librave të gjendjes civile, ndërsa 20 komuna (Rahovec, Skenderaj, Pejë, Shtërpçë, Leposaviq, Klllokot, Istog, Zveçan, Podujevë, Viti, Hani Elezit, Mamushë, Prishtinë, Lipjan, Mitrovicë Veriore, Partesh, Zubin Potok, Suharekë, Gjakovë dhe Gjilan) ende nuk kanë përfunduar. Lidhur me këtë, në 33 komuna numri i zyrtarëve komunal që janë certifikuar (që u janë nënshtruar testit të njohurive ligjore/procedurale dhe të sistemit) është 417, ndërsa 5 komuna (Vushtrri, Partesh, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan) nuk kanë zyrtar të certifikuar.

2.3.6. Arsimi dhe Kultura

Sipas të dhënave, në institucionet parashkollore në komuna janë të përfshirë gjithsejtë 20,512 fëmijë. Në 17 komuna është hartuar pakoja e materialeve për informimin e prindërve rreth rëndësisë së arsimit të fëmijëve me nevoja të veçanta, ndërsa në 21 komuna (Ferizaj, Suharekë, Shtime, Obiliq, Vushtrri, Mamushë, Malishevë, Mitrovicë Veriore, Partesh, Zubin Potok, Klinë, Skenderaj, Junik, Graçanicë, Leposaviq, Klllokoti, Vitia, Istogu, Fushë Kosovë, Podujeva dhe Hani Elezit) ende nuk është hartuar kjo pako. Në 31 komuna është zbatuar udhëzuesi për mësimdhënës për vlerësimin e nxënësve me nevoja të veçanta në mësim-nxënie, ndërsa 7 komuna (Klinë, Graçanicë, Leposaviq, Mamushë, Mitrovicë Veriore, Gjakovë dhe Klllokot) nuk e kanë zbatuar ende këtë udhëzues. Gjatë periudhës Janar–Dhjetor 2016, në 33 komuna janë ndërmarrë aktivitete të ndryshme me qëllim të përmirësimit të cilësisë dhe qasjes në arsim për

fëmijët me aftësi të veçanta, komunitetin pakicë, grupet e marginalizuara, si vijon: janë zhvilluar trajnime me mësimdhënës në shkolla, janë organizuar ekipe për parandalimin e braktisjes së shkollës nga fëmijët, por edhe për identifikimin e fëmijëve të cilët nuk kanë qasje në shkollë, janë organizuar takime me prindër dhe mësimdhënës.

Numri i braktisjes së shkollës nga komuniteti RAE




Fig.20. Numri i nxënësve nga komuniteti RAE që braktisin shkollimin sipas komunave

Gjatë periudhës Janar -Dhjetor 2016, në 11 komuna numri i braktisjes së shkollimit nga komuniteti pakicë është 308 nxënës, ndërsa 17 komuna (Mamushë, Prishtinë, Malishevë, Lipjan, Mitrovicë Veriore, Deçan, Skenderaj, Shtërpçë, Leposaviq, Novobërdë, Suharekë, Vushtri, Gjilan, Istog, Mitrovicë, Viti dhe Podujevë) nuk kanë nxënës që kanë braktisur shkollimin, si dhe 10 komuna nuk kanë komunitet RAE.

2.3.7. Mjedisi

Plani për menaxhimin e mbeturinave – Është miratuar në 28 komuna, ndërsa 10 komuna (Lipjan, Mamushë, Skenderaj, Shtërpçë, Leposaviq, Obiliq, Ferizaj, Shtime, Fushë Kosovë dhe Zveçan) ende nuk e kanë miratuar. Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2016, në 30 komuna numri i punëtorëve të organizuar për hartimin e planeve komunale dhe rregulloreve për mbeturina është 193, ndërsa 8 komuna (Fushë Kosovë, Kamenicë, Leposaviq, Shtërpçë, Suharekë, Zubin Potok, Mamushë dhe Mitrovicë Veriore) nuk kanë organizuar ndonjë punëtor. Gjithashtu, në 33 komuna janë trajnuar gjithsej 144 zyrtar, ndërsa 5 komuna (Kaçanik, Leposaviq, Shtërpçë, Mamushë dhe Mitrovicë Veriore) nuk kanë trajnuar ndonjë zyrtar.

Fushatat vetëdijësuese - Në 27 komuna, numri i fushatave të ndërmarra për ndërgjegjësimin publik për sistemin e menaxhimit të mbeturinave është 173, ndërsa 11 komuna (*Deçan, Gjakovë, Kaçanik, Kamenicë, Leposaviq, Podujevë, Shtërpçë, Suharekë, Klllokot, Mamushë dhe Mitrovicë Veriore*) nuk kanë mbajtur fushata për ndërgjegjësimin publik për sistemin e menaxhimit të mbeturinave.

Vlerësimi dhe plani reformues i sektorit të menaxhimit të mbeturinave të ngurta - Ky plan është përgatitur në 15 komuna, ndërsa në 23 komuna (Ferizaj, Suharekë, Obiliq, Shtime, Gjilan, Novobërdë, Ranillug, Dragash, Mamushë, Lipjan, Mitrovicë Veriore, Partesh, Zubin Potok, Deçan, Skenderaj, Leposaviq, Shtërpçë, Graçanicë, Kamenicë, Istogu, Fushë Kosovë, Podujevë dhe Hani Elezit) nuk është përgatitur.

Inventari për mbeturina të rrezikshme dhe vlerësimi i gjendjes – Është përgatitur në 10 komuna, ndërsa në 28 komuna (Ferizaj, Suharekë, Obiliq, Shtime, Gjakovë, Gjilan, Vushtrri, Novobërdë, Ranillug, Dragash, Mamushë, Prishtinë, Prizren, Lipjan, Malishevë, Kaçanik, Mitrovicë Veriore, Partesh, Zubin Potok, Deçan, Glogoc, Klinë, Pejë, Skenderaj, Shtërpçë, Rahovec, Graçanicë dhe Leposaviq) nuk është përgatitur. Në 28 komuna numri i deponive ilegale është 731.

Programi për mbrojtje të ujërave - Programin e masave për mbrojtjen nga veprimet e dëmshme të ujërave e kanë miratuar 11 komuna, ndërsa 27 komuna (Ferizaj, Suharekë, Ranillug, Obiliq, Shtime, Gjakovë, Gjilan, Vushtrri, Novobërdë, Mamushë, Malishevë, Mitrovicë Veriore, Klinë, Rahovec, Pejë, Skenderaj, Junik, Shtërpçë, Graçanicë, Leposaviq, Kamenicë, Zveçan, Mitrovicë, Podujevë, Klokot, Fushë Kosova dhe Hani Elezit) nuk e kanë miratuar ende.

2.3.8. Bujqësia

Në kuadër të masave komunale për mbrojtjen e tokës bujqësore, gjatë periudhës raportuese Janar – Dhjetor 2016, në 28 komuna numri i kërkesave të parashtruara është 2381, ndërsa 10 komuna (Gjakovë, Dragash, Mitrovicë, Leposaviq, Obiliq, Viti, Zveçan, Hani Elezit, Ranillug dhe Mitrovicë Veriore) nuk kanë pasur kërkesa të parashtruar. Në 21 komuna numri i lejeve të lëshuara është 773, ndërsa 17 komuna (Gjakovë, Gjilanë, Dragash, Klinë, Mitrovicë, Leposaviq, Lipjan, Obiliq, Shtërpçë, Suharekë, Viti, Zveçan, Malishevë, Mamushë, Partesh, Ranillug dhe Mitrovicë Veriore) nuk kanë pasur ndonjë leje.

Plani për Menaxhimin e tokave rurale - Është hartuar në 14 komuna, ndërsa në 24 komuna (Deçan, Rahovec, Pejë, Graçanicë, Leposaviq, Glogoc, Istog, Fushë Kosovë, Podujevë, Hani Elezit, Mitrovicë, Prizren, Dragash, Mamushë, Prishtinë, Lipjan, Kaçanik, Mitrovicë Veriore, Obiliq, Gjilan, Gjakovë, Vushtrri, Novobërdë dhe Zveçan) nuk është hartuar.

2.3.9. Bashkëpunimi ndërkomunal dhe komunal ndërkombëtar

Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2016, 8 komuna kanë pasur 12 projekte. Ndërsa 30 komuna (Ferizaj, Suharekë, Shtime, Gjakovë, Vushtrri, Novobërdë, Malishevë, Mamushë, Lipjan, Prishtinë, Kaçanik, Mitrovicë Veriore, Partesh, Zubin Potok, Glogoc, Klinë, Rahovec, Pejë, Junik, Skenderaj, Graçanicë, Leposaviq, Shtërpçë, Klokoti, Zveçan, Mitrovicë, Kamenicë, Podujevë, Fushë Kosovë dhe Hani Elezit) nuk kanë marrë pjesë në asnjë projekt të BNK-së.

Po ashtu, gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2016, 15 komuna kanë pasur 45 marrëveshje të bashkëpunimit ndër-komunal, ndërsa 23 komuna (Ferizaj, Gjakovë, Vushtrri, Suharekë, Shtime, Ranillug, Malishevë, Mamushë, Prishtinë, Kaçanik, Mitrovicë Veriore, Zubin Potok, Glogoc, Klinë, Rahovec, Pejë, Junik, Skenderaj, Leposaviq, Shtërpçë, Podujevë, Zveçan dhe Hani Elezit) nuk kanë marrëveshje ndonjë të nënshkruar. Gjithashtu, gjatë periudhës raportuese, 15 komuna kanë realizuar 25 marrëveshjeve të bashkëpunimit komunal ndërkombëtar, ndërsa 23 komuna (Shtime, Gjilan, Vushtrri, Novobërdë, Ranillug, Malishevë, Mamushë, Prishtinë, Lipjan, Kaçanik, Mitrovicë Veriore, Partesh, Zubin Potok, Klinë, Rahovec, Pejë, Skenderaj, Leposaviq, Shtërpçë, Hani Elezit, Podujeva, Istog dhe Kamenicë) nuk kanë asnjë marrëveshje.

3. Financat Lokale

3.1. Planifikimi i të hyrave vetanake

Planifikimi i të hyrave vetanake në vlerë prej 79,622,353.00 € për vitin 2016 krahasuar me vitin 2015 në vlerë prej 74,243,215.00 € është më i lartë për 5,379,138.00€ ose për 7%.

3.2. Realizimi i të hyrave vetanake

Komunat mbledhin të hyrat vetanake në dy forma:

- Të hyrat e mbledhura drejtpërdrejtë nga komuna si aktivitet i komunës; dhe
- Të hyrat e arkëtuara nga niveli qendror (të hyrat indirekte) të cilat transferohen në komuna si pjesë përbërëse e të hyrave vetanake.

Realizimit i të hyrave direkte dhe indirekte në vitin 2016, ka qenë 71,025,872.71€ ose 89% të buxhetit të planifikuar prej 79,622,353.00€.

Mbledhja e të hyrave vetanake direkte në vitin 2016 ka qenë 66,230,620.97 €, që krahasuar me vitin 2015 sa ishte 53,285,294.90 €, është më e madhe për 12,945,326.07 € ose një rritje prej 11.41 %€.

Duke marrë për bazë të dhënat zyrtare nga Sistemi Informativ i Menaxhimit të Financave të Kosovës – SIMFK, Departamenti i Thesarit - MF, gjatë periudhës raportuese komunat kanë grumbulluar 66,230,620.97€ të hyra vetanake direkte, ose 83% nga niveli i planifikuar vjetor prej 79,622,353.00€.

Komunat të cilat kanë realizuar më së shumti të hyra vetanake mbi 100% janë: Parteshi, Hani i Elezit, Rranillugu, Novobërda, Deçani, Graçanica, Skenderaji, Fushë Kosova, Lipjani dhe Shtimja. Ndërsa, komunat që kanë realizuar të hyra vetanake në një shkallë të ulët nën 10% janë: Zveçani; Leposaviqi; Zubin Potoku.

Të hyrat që kanë një ndikim më të madh në rritjen e të hyrave vetanake janë tatimi ne pronë i cili gjatë vitit 2016 është inkasuar në shumë prej (25,436,643 €). Në këtë vit inkasimi i tatimit në pronë ka qenë më i madh se në periudhën e njëjtë të vitit 2015 për 19,914,321 €.

Kategori tjetër me ndikim në buxhetin komunal janë edhe të hyrat komunale për leje ndërtimi. Nga kjo kategori gjatë vitit 2016 është inkasuar shuma prej 17,293,233 €, që krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2015 janë inkasuar 12,020,331 € më shumë.

Sa u përket të hyrave nga ndërrimi i destinimit të tokës, në vitin 2016 janë inkasuar 1,707,936€, që nënkupton se nga kjo kategori ka pasur ulje të inkasimit në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2015 dhe atë në vlerën prej 2,022,868€.

3.3. Buxhetimi komunal për vitin 2016

Bazuar në të dhënat zyrtare nga Sistemi Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës (SIMFK) - Departamenti i Thesarit - Ministria e Financave, Komunitet i Republikës së Kosovës për vitin 2016 i kanë shpenzuar buxhetet e tyre në vlerë të përgjithshme prej 404,141,917.32 € ose 91% e buxhetit të planifikuar në vlerë prej 443,787,822.23 €. Bazuar në gjendjen e fundit të raporteve vjetore në SIMFK buxhetimi i komunave për vitin 2016 është me i vogël për (12,787,751.18 €) krahasuar me vitin 2015, përkatësisht në vitin 2016 është 443,787,822.23 €, ndërsa në vitin 2015 është 456,575,573.41 €.

3.4. Shpenzimet krahasuar me buxhetimin

Buxheti i komunave të Republikës së Kosovës sipas kategorive ekonomike në përgjithësi është shpenzuar si vijon:

- **Kategoria e rrogave dhe pagave**, është planifikuar në vlerë prej 248,982,106.22€, ndërsa është shpenzuar në vlerë prej 246,640,507.70€, ose 99%.
- **Kategoria e mallrave dhe shërbimeve**, është planifikuar në vlerë prej 40,232,605,23€ ndërsa është shpenzuar në vlerë prej 38,506,923.49 € ose 96%.
- **Shpenzimet komunale**, janë planifikuar në vlerë prej 9,636,769.32€, ndërsa janë shpenzuar 9,140,015.45 €, ose 95%.
- **Subvencionet dhe transferet**, të planifikuara në vlerë prej 10,001,088.96 €, të shpenzuara 8,846,806.92€ ose 88%;
- **Shpenzimeve kapitale**, të planifikuara në vlerë prej 134,935,252.50 €, kurse janë shpenzuar 101,007,663.76 € ose 75%.

Nëse i krahasojmë kategoritë ekonomike atëherë shohim se kategoria e rrogave dhe pagave është shpenzuar më së shumti deri 99%, ndërsa më së paku është shpenzuar kategoria e shpenzimeve kapitale (75%) krahasuar me buxhetimin.

Në vijim është paraqitur figura krahasuese në mes planifikimit dhe shpenzimit të buxheteve komunale sipas kategorive buxhetore:

Raporti në mes planifikimit dhe shpenzimit




Fig.21. Planifikimi dhe shpenzimi i buxhetit sipas kategorive në komuna

Shprehur në përqindje, shpenzimet buxhetore sipas kategorive janë si në vijim:

Kategoria e rrogave dhe pagave krahasuar me planifikimin është shpenzuar në 36 komuna prej 90%-100% ndërsa në 2 komuna është shpenzuar (85% në Zveqan; 48% në Mitrovicën Veriore) krahasuar me buxhetimin .

Kategoria e mallrave dhe shërbimeve krahasuar me buxhetimin është shpenzuar në nivelin nga 90% - 100% në 31 komuna ndërsa në 7 komuna në nivelin prej 80% - 87% .

Kategoria e Shpenzimeve Komunale krahasuar me buxhetimin është shpenzuar në nivelin 90% - 100% në 34 komuna; në 3 komuna është shpenzuar në nivelin 72% - 86% dhe komuna e Zubin Potok me zero shpenzim.

Kategoria e Subvencioneve dhe transfereve krahasuar me planifikimin është shpenzuar në nivelin 90% - 100% në 25 komuna në 7 komuna është shpenzuar në nivelin 83% – 89% ; në 5 komuna është shpenzuar në nivelin 62%– 76% dhe në komunën e Zveqanit me zero shpenzim.

Kategoria e Shpenzimeve kapitale (pasuritë jofinanciare) krahasuar me planifikimin është shpenzuar në 7 komuna 90% - 100% në 15 komuna është shpenzuar 80% – 88% në 11 komuna është shpenzuar 62% – 79%; dhe në 4 komuna është shpenzuar 35%-58% dhe në komunën e Zubin Potokut është shpenzuar 4% krahasuar me buxhetimin .

Komunat të cilat kanë arrit të shpenzojnë në total buxhetin në nivel më të lartë prej 91% - 99% të nivelit vjetor të buxhetuar janë 31 komuna ; në 4 komuna është shpenzuar 80%-88% dhe në 3 komuna janë shpenzuar 56%-63%.

Përfundime

- Gjatë vitit 2016, Kuvendet e komunave të Republikës së Kosovës kanë përmbushur normën ligjore për mbajtjen e së paku 10 takimeve brenda një viti.
- Informimi i qytetarëve në vazhdimësi është bërë përmes faqes zyrtare të komunës shpalljeve të vendosura në objektet e komunave, televizioneve lokale dhe forma të tjera të informimit publik.
- Komitetet e obligueshme kanë qenë funksionale në të gjitha komunat, duke realizuar mandatin e tyre në përputhje me legjislacionin përkatës.
- Komunat kanë themeluar një numër të konsiderueshëm të komiteteve konsultative, si mundësi e mirë për përfshirjen e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes.
- Me përjashtim të një rasti, të gjithë kryetarët e komunave kanë përmbushur detyrimet për raportim para kuvendeve të komunave;
- Obligimi për mbajtjen e së paku 2 tubimeve publike gjithpërfshirëse me qytetarë është përmbushur në 32 komuna.
- Sa u përket dëgjimeve buxhetore, 31 komuna kanë përfshirë qytetarët gjatë procesit të hartimit të buxhetit komunal.
- Kuvendet e komunave kanë qenë aktive në hartimin e akteve nënligjlore.
- Edhe gjatë kësaj periudhe janë evidentuar raste të shkeljeve ligjore me rastin e nxjerrjes së këtyre akteve.
- Prej 38 akteve të kundërligjshme, komunat kanë harmonizuar me ligj vetëm 18 akte pas kërkesës për rishqyrtim, ndërsa 20 akte mbesin për t'u harmonizuar.
- Këshilli komunal për siguri në bashkësi është themeluar në 34 komuna, ndërsa nuk është themeluar në Komunat: Leposaviq, Mitrovicë Veriore, Zveçan dhe Zubin Potok.
- Përmbushja e obligimeve të dala nga agjenda evropiane nga komunat për vitin 2016 ka qenë 73%.
- Sa i përket menaxhimit buxhetor, komunat kanë treguar performancë më të mirë se në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Në total, është arritur të shpenzohet 91% të buxhetit të planifikual.
- Kategoria e shpenzimeve kapitale është shpenzuar në masë më të ulët se kategoritë e tjera buxhetore.
- Tri kategoritë që kanë ndikuar më së shumti në krijimin e të hyrave vetanake në komuna kanë qenë: tatimi në pronë, të hyrat nga lejet ndërtimore dhe ndërrimi i destinimit të tokës komunale.

Rekomandimet e përgjithshme

- Komitetet e tjera të ushtrojnë funksionet e tyre në aspektin e mbikëyrjes së punës së sektorëve të caktuar brenda administratës komunale dhe të japin më tepër kontributin e në shqyrtimin paraprak të pikave të rendit të ditës.
- Komunitet të cilat nuk kanë themeluar komitetet konsultative, duhet të shohin mundësinë e themelimit të tyre për të shtuar prezencën e qytetarëve në vendimarrjen lokale.
- Kryetari i Komunës së Klllokotit duhet të raportoj në baza të rregullta dhe kurdo që kërkohet nga anëtarët e Kuvendit të Komunës.
- Përfaqësuesit e ekzekutivit duhet të shtojnë prezencën e tyre gjatë zhvillimit të mbledhjeve të Kuvendit Komunal;
- Komunitet: Fushë-Kosovë, Mitrovicën Veriore, Leposaviqi, Zveçan, Zubin Potoku dhe Klllokoti, të mbajnë së paku dy takimet publike me qytetarë sipas nenit 68 LVL-së
- Komunitet: Mamushë, Partesh, Mitrovicë Veriore, Leposaviq, Ranillug, Gjakovë dhe Zveçan, të mbajnë dëgjimet publike buxhetore me qytetarë.
- Të harmonizohen me ligj të gjitha vendimet e kundërligjshme të kuvendeve të komunave: Kamenicë, Ranillug, Graçanicë, Gjakovë, Zubin Potok, Glllogovc, Dragash, Deçan, Novobërdë, Obiliq, Malishevë dhe Klllokot.
- Të themelohen Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi nga komunitet: Leposaviq, Mitrovicë Veriore, Zveçan dhe Zubin Potok.
- Të mbahen me rregull takimet e KKS-vë nga Komunitet: Fushë Kosovë, Prishtinë dhe Klllokot.
- Komunitet e Junikut dhe Ranillugut të marrin pjesë në trajnimet e organizuara për forcimin e administratës komunale.
- Të hartohen dhe miratohen rregulloret për përdorimin e gjuhëve në kuvendet e komunave: Mitrovicë Veriore, Ranillugu, Zveçani dhe Leposaviqi.
- Të sigurohet publikimi i plotë i akteve në ueb-faqet zyrtare të komunave: Mamushë, Malishevë, Podujevë, Leposaviq, Mitrovicë Veriore, Partesh dhe Zubin Potok.
- Të themelohen Qendrat për Shërbim të Qytetarëve në Komunën e Zveçanit dhe Leposaviqit.
- Komunitet të respektojnë legjislacionin në fuqi për përfaqësimin e komuniteteve joshumicë dhe respektimin e barazisë gjinore në administratën publike.
- Komunitet: Shtërpçë, Leposaviq, Dragash, Mamushë, Mitrovicë Veriore, Partesh, Zubin Potok, Gjilan, Novobërdë, Ranillug, Klllokot dhe Hani Elezit, të shohin mundësinë e subvencionimit të aktiviteteve të shoqërisë civile.

- Rregullorja për të drejtat e fëmijëve të aprohet në të gjitha komunat.
- Komunat të shtojnë aktivitetet e tyre në drejtim të përkrahjes së sektorit të biznesit dhe të krijojnë kushte për rritjen e zhvillimit ekonomik lokal.
- Komuna e Leposaviqit të kujdeset në sigurimin e shtrirjes së infrastrukturës së teknologjisë informative në të gjitha institucionet e administratës publike lokale.
- Të hartohet Plani për energji eficiente në komunat: Mamushë, Mitrovicë Veriore, Skenderaj, Leposaviq, Ranillug, Kllokot, Hani Elezit, Graçanicë dhe Prishtinë.
- Komunat gjatë viteve të ardhshme të orientojnë investimet kapitale në sigurimin e infrastrukturës së domosdoshme (kritike), duke përfshirë: rrjetin e ujësjellësit publik, kanalizimeve, rrugëve dhe ndriçimit publik.
- Komunat të shtojnë kujdesin në planifikimin e drejtë të të hyrave, duke shfrytëzuar mekanizmat përkatës ligjor dhe administrativ për rritjen e realizimit të tyre. Gjithashtu, komunat të bëjnë planifikime adekuate për rritjen e efikasitetit në shpenzimin e mjeteve buxhetore, e posaqërisht në kategorinë e investimeve kapitale.

Shtojcë 1-Shkeljet ligjore të cilat janë rishqyrtuar dhe janë harmonizuar konform kërkesave të organit mbikëqyrës

Shkeljet e konstatuara	Komuna	Statusi i lëndës
Vendimi Nr. 011-6010 për shpalljen e interesit publik me qëllim të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të disa hapësirave shkollore	Gjakovë	E harmonizuar (25.03.2016)
Vendim për dhënien e në shfrytëzim të pronës komunale 10 ari Bashkësisë Islame të Novobërdës për ndërtimin e Xhamisë	Novobërdë	E harmonizuar (29.09.2016)
Vendimi Nr. 038-88397 për formimin e grupit punues për plotësim-ndryshimin e Rregullores për Organizimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatra, Vendbanime dhe Lagjeve Urbane	Prishtinë	E harmonizuar (06.05.2016)
Vendimin komunal Nr.046-88452, për lejimin e afatit shtesë Agjencisë Kosovare të Privatizimit për lirin e hapësirave të cilat i janë dhënë me qira në bazë të kontratës 01Nr. 046-50871/1	Prishtinë	E harmonizuar (06.05.2016)
Vendimi Nr. 038-88382 për caktimin e komisionit për udhëheqjen dhe koordinimin e punës për përzgjedhjen e Këshillave të Fshatrave, Vendbanimeve dhe Lagjeve Urbane	Prishtinë	E harmonizuar (06.05.2016)
Vendim Nr.01/11-92214 për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale	Prizren	E harmonizuar (27.07.2016)
Vendimi Nr. 127/16 për Dhënien në Shfrytëzim Afatgjatë të Pronës së Paluajtshme Ndërtimore të Komunës së Vushtrrisë	Vushtrri	E harmonizuar (28.07.2016)
Vendim Nr. 2119 paraprak për dhënien në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme të Komunës në Shfrytëzim Afatshkurtër	Rahovec	E harmonizuar (27.09.2016)
Vendim Nr.02/95 për hapjen e diskutimit publik për plotësim-ndryshimin e Rregullores së tatimit në pronën e paluajtshme për vitin 2017	Junik	E harmonizuar (25.08.2016)
Vendim Nr.02/96 për formimin e grupit të punës për hartimin e (projekt) Planit të punës së Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2017	Junik	E harmonizuar (25.08.2016)
Vendim Nr. 01-70 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës së Ferizajt destinuar për zhvillim ekonomik	Ferizaj	E harmonizuar (25.08.2016)
Vendimi Nr. 01-68 për Dhënien në Shfrytëzim Afatgjatë të Pronës së Paluajtshme të Komunës së Ferizajt e Destinuar për Zhvillim Ekonomik	Ferizaj	E harmonizuar (25.08.2016)

Vendimi Nr. 1-71 për zëvendësimin e anëtarit të komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës nga OJQ-të z. Valmir Sadiku me anëtarin e ri z. Musli Mjeku	Obiliq	E harmonizuar (28.09.2016)
Vendim Nr. 8068/2016 për këmbimin e pronës	Hani i Elezit	E harmonizuar (31.08.2016)
Vendim Nr.02/102 për themelimin e Komisionit të ankesave	Junik	E harmonizuar (28.10.2016)
Vendim Nr. 464-49099 për shpalljen e interesit publik lidhur me pronën nr. 8022, evidentuar si pronë e paluajtshme e Agjencinë Pyjor të Kosovës drejtoria regjionale Mitrovicë	Skenderaj	E harmonizuar (28.09.2016)
Vendimi Nr.16-7409 për miratimin e nismës së kryetarit të komunës për të hyrë në bashkëpunim komunal ndërkombëtar me komunën Serik të Republikës së Turqisë	Suharekë	E harmonizuar (Mbledhja e muajit nëntor)
Vendimi Nr.001/011-164948 , mbi bartjen administrative të pronës së ish Sekretariatit Federativ për mbrojtje popullore (ish APJ) në pronë publike komunale	Prizren	E harmonizuar (09.02.2017)

Shtojcë 2 - Shkeljet ligjore të cilat nuk janë rishqyrtuar konform kërkesave të organit mbikëqyrës

Shkelja e konstatuar	Komuna	Statusi i lëndës
Vendimi nr.01.5999 për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim me koncesion personave fizik/juridik	Kamenicë	Nuk është rishqyrtuar
Vendimi Nr.02-035 për miratimin e raportit të komisionit për vlerësimin e ofertave për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim	Ranillugë	Nuk është rishqyrtuar
Vendimi Nr. 2136/16 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë 99 vjet, të pronës së paluajtshme të komunës për strehim banesor të familjes së z.Malden Stanojeviq, parcelën kadastrale nr. P-597/21 ZK-Graçanicë	Graçanicë	Nuk është rishqyrtuar
Vendimi Nr. 2133/16 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë 99 vjet, të pronës së paluajtshme të komunës për nevojat e zgjedhjes së strehimit banesor të familjes së z.Srbobran Rashiq, në parcelën kadastrale nr. P-485/8 ZK Graçanicë, e cila është në pronësi të komunës së Graçanicës	Geaçanicë	Nuk është rishqyrtuar
Vendimi Nr. 2135/16 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë 99 vjet, të pronës së paluajtshme të komunës për nevojat e zgjedhjes së strehimit banesor të familjes së z.Marko Miljković, në parcelën kadastrale nr. P-1946 ZK Graçanicë, e cila është në pronësi të komunës së Graçanicës	Graçanicë	Nuk është rishqyrtuar
Vendimi Nr. 2134/16 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë 99 vjet, të pronës së paluajtshme të komunës për nevojat e zgjedhjes së strehimit banesor të familjes së z.Ivan Miljković, në parcelën kadastrale nr. P-1946 ZK Graçanicë, e cila është në pronësi të komunës së Graçanicës	Graçanicë	Nuk është rishqyrtuar

Vendim paraparak Nr.011-23746 për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale	Gjakovë	Nuk është rishqyrtuar
Vendimi për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite për ndërtimin e shtëpisë	Zubin Potok	Nuk është rishqyrtuar
Vendimi Nr.400-34429 për dhënien shfrytëzim 10 vite aneksin e komunës OJQ Qëndresa për promovimin e të drejtave të grave në komunën e Glllogocit	Glllogoc	Nuk është rishqyrtuar
Vendimi Nr. 06-105211/2 për Dhënien në Shfrytëzim Afatshkurtër të Pronës së Paluajtshme të Komunës	Dragash	Nuk është rishqyrtuar
Vendimi 01.Nr.IX për shpalljen e fituesit të ofertës së përzgjedhur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të tokës ndërtimore komunale me konkurs Lloti Nr.06	Deçan	Nuk është rishqyrtuar
Vendimi Nr.01-964 i miratuar me 29.09.2016 për dhënien në shfrytëzim të përkohshme të objektit shkollor ekzistuese	Novobërdë	Nuk është rishqyrtuar
Vendimi 01.Nr.X-4 për kushtëzimin e pagesës për mbeturina në disa shërbime komunale	Deçan	Nuk është rishqyrtuar
Vendimi Nr. 1-93 për iniciimin e procedurave për Dhënien e ngastrave kadastrale me Nr. 01353-1 dhe Nr.01352-6 në shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme të Komunës së Obiliqit	Obiliq	Nuk është rishqyrtuar
Vendimi paraparak Nr. 011-46864 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunës në zonën kadastrale Jahoc	Gjakovë	Nuk është rishqyrtuar
Vendimi Nr.02-342 për rritjen e numrit të anëtarëve të KPF-së	Malishevë	Nuk është rishqyrtuar
Vendimi Nr.8023/2 për shkeljen e nenit 18.2 të Statutit të Komunës së Klllokotit, nga Kryetari i Komunës	Klllokot	Nuk është rishqyrtuar
Vendimi Nr.8024/2, për zbatimin e vendimeve të Kryetarit	Klllokot	Nuk është rishqyrtuar
Vendim Nr.8025/2 për shkeljen e ligjit për qasje në dokumente publike Nr.03/L-215	Klllokot	Nuk është rishqyrtuar
Vendim Nr. 02-365 për emërimin e anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa.	Malishevë	Nuk është rishqyrtuar